

BUZUKU

numër 35

SHOQATA D. GJON
ULQIN
BUZUKU

Revistë informative, kulturore e shoqërore
Ulqin, e enjte më 14 prill 2011, çmimi 1€, 2\$



Përkujtim festiv me rastin e 100 vjetorit të ngritjes së flamurit kombëtar në Deçiq

(sih faqe 10-11)



Në Malsi të Mbishkodres - Mbas faljes së Sulltanit 1911.

Rreshti i parë: Gjeto Gjeka, bajraktari i Selcës; A. Bona Gjeçaj, famullitar i Grudës; Dom Ernest Cozzi, famullitar i Rrjollit; Dedë Coku; A. Sebastjan Hila, famullitar i Rapshtës; Shuk Serreggi; A. Lorenc Mitroviq, famullitar i Bajzës; Pjeter Gjokë Doda; A. Karlo Prennushi, famullitar i Vuksan-Lekaj; A. Luigj Bushati, famullitar i Traboinit.

Rreshti i dytë: Gjekë Mali; A. Matë Prennshi famullitar i Kastratit; Dedë Gjo' Luli; Imzot Ják Serreggi, Argjip. i Shkodres; Imzot Luigj Bunçi, Ip. i Lezhës; Gjelosh Gjoka, Kolë Dedë Gjo' Luli.

Rreshti i tretë: Kolë Páli; Zef Shuk Serreggi; Gjeto Daka.



Legjenda e Shestanit

N'Buzukun nr 34 lexova shkrimin tuaj për Shestan. Jam knaqun qi ju shum herë shkruoni për Shestan. Ju kishit shkrua: Njerëzit dvesin, pej kah kanë ardhë shestanasit n'kta katune, si dhe qi ka shum legjenda. Ka shum dallime nërmjet shkrimeve të dy Gjokave, njëni Dabaj, tjetri Daboviq, të dy pej Gurrzet, Shestani Nalt. Shesatani ka 6 katune. Legjenda qi kena ditë dhe si asht folë e besuo, një Zef pej Shkrelit Shqypnisë, për arsye se kish r n'gjak, me 6 djelm vjen e ze ven n'Shestanin e soçëm, ku nuk do t'kijet pasë banorë. Sejcilli djalë i Zefit ka temeluo katunin e vet: Gjura – Gjuraçin (Gjuravce), Nreka - Nrekanjt (Karanikiq), Luka – Lukiqin, Deda – Dedanjt (Dediq), e Pera - Gurrzën. Njëni pej Peret ulet në Shestanin Posht, formon katunin Pecanj¹ (Dragevica, Peciq). Mâj vogli djalë i Zefit, Leka beqar shkon e martohet në ortodoks, merr fenë e tyne, kurse katuni merr emnin Lekiq. Nji djalë i Nreks – Vuça martohet me ortodokse, kalon n'atë fe, formon katunin Uçdabaj (Vuçedabiqi, Uçdabiq). Për Bujgrin thuhet qi e ka formuo një bugar; aj ka punuo n'nji manastir n'Goricë t'Madhë², ka ardhë në Shestan Posht, asht martuo me t'katolike dhe vet ai u bâ katolik.

Për sejcillin popull, si dhe për ne Shqyptarët, janë t'rânsishme tri gjâna kryesore qi caktojnë komin: **gjuha e nâns, veshja dhe hadetet**. Shestani t'gjitha kto i ka pasë t'veçanta: **gjuhën shqype, veshjen** e mrekullueshme dhe **hadetet** e veta. Nji shkrimtar malazez, Joviqeviq pej Cetinje, më 1924, ka kaluo nëpër t'gjidha katunet e Shestanit, ka shkruo një libër, ku i vërteton t'gjidha ato qi unë i shkrova ktu mâ nalt. Sot k shum shestanas qi zbukurohen për fat t'keq me veshje t'huoj.

Shestani ka pasë burra shum t'menshëm, por për fat t'keq p shkollë. S'ka pasë kush me lânë një dokument t'shkruom. Më 1900, knjaz Nikolla k ardhë n'Shestan, kërkoi me çil shkollën. Shestanasit ju lutën, edhe tri vjet mos me çilë shkollën se s'ka kush me'j ruojtë qinjat e edhat, se ata i kanë ruojtë deri atëherë. Knjazi u tha: Po m'dhimen thmija qi s'po u çilni shkollën. Ju kini me kjenë gjithmonë nën kâmë t'çerriçanëve (malazezve). Çe atëherë janë bâ mâ tepër se 100 vjet, edhe sot na jena nën kâmën e tyne.

N'kohën e luftës³, kojshitë tonë janë vr nër veti, djegë shpijat, mushë llogoret. N'Shestan me rrethina (20 katune) kurrkush nuk u vr , asnjë shpi e djegun, askush i internuam. Shestanasit jo vetëm se kanë pshtuo vetin, por kanë pshtuo Çerriçën. Njeriu qi e pshtoi Shestanin, për fatë t'keq, aj u bâ kurban i tij. Për ket arsye, asnji shestanas nuk duhet të turpnohet, por t'burrohet qi asht shestanas.

Shkruan Gjergji Leks Macit Kols (26.08.1926-), Shestans, Te-Pleva, Fusha Tivarit; më 01.03.2011.

1.a.Kola'j Luk's Macit Luk'Pâlit-Pecaj, Mali Bardhë, Ulqin, thotë, si mbas legjendës, që Pecanjt janë prej Pecajve të Shalës (Malësia e Mbishkodrës). 1.b.Nilajt (Nilonjt) e Ljares thonë se rrjedhin prej Grudës. 2.ishull (adë) në Liqe të Shkodrës. 3.Lufta II Botërore (Përgatiti SGjD).

Aj qi nuk e do gjuhën e nanës, aj nuk e do as vetveten.

Aj qi nuk e neron gjuhën e nanës, aj hupen t'parët e vet dhe fmijët e vet (SGjD).

Gosta e gurriqit

N'gosta t'gurriqit janë thirrë vetëm nusët e kushrinjvet ose pej katuni. Për nusët, si ka kjenë kuma (nriklla), ka kjenë e caktuome nata e dytë e Kshnellavet. Nusja e pobros (sivëllamit), nusët pej dajet, tezave, hallave dhe bijash janë thirrë posaçëm në shtune mrama ose në dielle mrama; n'atë gostë janë thirrë edhe miq tjerë. N'ato raste asht luojt valle. N'katunin Nrekaj Nalt, vallja asht luoajt në shpinë e Luks Markut Lucit Pushit Luks-Lukolaj (Lukoliq); aj ka pasë shpi t'madhe dhe atë natë e ka liruo për me luojt valle. Në Nrekaj Posht asht luojt valle te Gjokë Lula, n'Bujgër – te Preçi Macit Preçit, kuse n'Gjuraç – te Nika'j Pjetrit Vuks. Ktu shum kush nuk ka pasë shpi për valle, por ka kjenë dashni, ashtu qi kta qi përmena, gjithmonë kanë liruo shpijat e veta. Kur ka kjenë vallja n'Shestan Posht, aty janë mledhë Gjuraçi, Nrekanjt, Bujgri dhe Pecanjt. N'valle gjithmonë **janë knuo kangë shqype**, asht kcyë dibrance dhe krushqisht. Edhe mas çlirimmit asht knuo shqyp. T'partë qi kanë filluo me knuo n'valle nashke (malazezçe) janë pej Shestanit Nalt, e mosenej kanë filluo edhe n'katunin Pecaj, ashtu qi disa shestanas u bânë mâ luthtar e patriotë se Titoja.

Shkruan Gjergji Leks Macit Kols (26.08.1926-), Shestans, Te-Pleva, Fusha Tivarit; më 01.03.2011.



Në BUZUKUN 34/2010, faqe 6, shkruan: Gjergji Leks Markut Çobas-Dabaj,... duhet: Gjergji Leks Markut Çobas-Dedonj (Dediq). Për gabim prej lexuesve kërkohmë falje.

PËRMBAJTJA

2. Lexuesit na shkruajnë
3. Pjetri, ipeshkëv i Shasit, më 1166
4. Prof. Gëzim Uruçi përshëndeten
5. Kalaja e Samoborit - vendbanim ilir
6. Fisnikja shqiptare bashkëshorte e themeluesit të Cetinës
7. Plotësim për Zezalitë - Crnojeviqët
7. Për valle e veshje të Shestanit
8. Shkollimi shqip në komunën e Plavës
10. Vallja e Shestanit në Shkodër
12. Dokument - fotografi e moçme
14. Pal Deshpali vazhdon aktivitetin
15. Mullijtë e Malësisë së Rozhajës
16. Ruani ullinjë - alramojnë të rinjtë
16. Burrnohemi me nënën Tereze
17. Art Club - njëzet vjet kulturë
18. Shqiptari themeloi Egjiptin
20. Poezi
21. Popullore
22. Popullore
23. Të ndryshme

Buzuku 35

REVISTË E PËRKOSSHME INFORMATIVE, KULTURORE E SHOQËRORE

Boton:

Shoqata për kulturë " Dom Gjon Buzuku "

Këshilli programor:

Gjergj Pepgjoni, Mr. Rrok Gjolaj, prim.dr.Gani Karamanaga, prof.dr. Mentor Disha, prof.dr.Hysni Hoxha, prof.dr.Jahja Drançolli, Vera Kovaçi, Lekë Brisku, Mitër Pekaj, Gjystina Dabaj, Gjergj Perkolaj, Zef Kovaçi, Mark Junku, Gjurë Dabaj,

Lubo Lukiqi

Kryeredaktor:

Simë Gjon Dobreci

Ndihmës i kryeredaktorit

Gjekë Gjonaj

Redaksia:

Mr. Riza Rexha, prof.dr. Ruzhdi Ushaku, Prof. Dr. Hajrullah Koliqi, Idriz Ulaj, Loro Markiqi, Ali Gjeçbritaj, Pjetër Ivezaj, dr.Lukë Gjokaj, Kolë Camaj, Zef Lukiqi, Drane Marvuçiqi, Gjekë Dabaj

Fotoshërbimi:

Foto Studio Ars, Foto Rozafa, Foto Arb, Art Foto Prishtinë, Foto Bruno

Realizimi artistik:

Fisnik Dobreci & Gazmend Çitaku

Adresa e redaksisë:

Bul. Gjergj Kastrioti Skënderbeu

85360 ULQIN

Nr.tel. ++382 (0) 30 401-384, 069 441-943

www.buzuku.info

E-mail: fdobreci@t-com.me;

Loromark@t-com.me

Numri i llogarisë rrjedhëse

Banka komerciale malazeze A.D.

Ekspozitura Ulqin Nr. 510-0-40

Thirrje ne Nr. 510270393491001825

Revista është regjistruar në Sekretariatin Republikan për Informata të Malit të Zi, nr. 04 / 01- 466

Dorëshkrimet dhe fotografitë nuk kthehen

Pjetri, ipeshkëv i Shasit, më 1166

Pjetri, ipeshkëv i Shasit (Suacinense), mori pjesë në shenjtërimin e katedrales katolike të Kotorrit më 1166. Shenjtërimin e bëri ipeshkvi Majo me Lazrin (ipeshkvi i Shqipërisë) dhe me Gjonin (ipeshkvin e Ulqinit). Ishin të pranishëm edhe Gjoni - ipeshkëv i Tivarit, Gjergji - ipeshkëv i Shenjtit Shpëtimtar të Shqiptarëve, Pjetri - ipeshkëv i Shirgjit (në lindje të Bunës) dhe Andria - ipeshkëv shqiptar. Pra, shumicën e autoriteteve fetare të këtij manifestimi e përbënin klerikët katolikë shqiptarë, ku përfshihet edhe Pjetri, ipeshkëv i Shasit.



Në Shas (rrethi i Ulqinit), shkrimi me shkronjat latine në murin e kishës së Shnjonit (Shën Gjonit) dëshmon që kjo kishë me siguri i takonte ritit katolik. Këtë dëshmi, jo vetëm që e përkrah, por edhe e vërteton dokumenti i shenjtërimin të Katedrales katolike të Kotorrit më 1166, ku, ndër të tjerë, mori pjesë edhe Pjetri, atëherë ipeshkëv i Shasit.

Shih DOKUMENTIN, Buzuku 31/2009:3.

Dokumentin ma mundësoi burri i ndershëm Jusuf Cen Lika, fotograf dhe veprimtar për të mirën e Ulqinit.

Përgatiti Simë Gjon Dobreci



Aj qi nuk e neron t'kaluemën, aj nuk e ka as t'ardhmën (SGjD).



Prof. GËZIM URUÇI
euroetnolog

Prof. GËZIM URUÇI përshëndeten

SHUMË I NDERUARI BURRË FISNIK!
GËZUAR E PËR SHUM MOT E JETË FESTËN E KRISHTLINDJEVE,
SI DHE - VITIN E RI - 2011.

PLOT SHËNDET E BEGATI NË FAMILJEN TUAJ.

GJITHASHTU GËZUAR EDHE 15 vjetorin e REVISTËS "BUZUKU"

TË CILËS I UROJ JETË TË GJATË SA ULLINJTË E KRUIJËS

SË GJERGJ KASTRIOTIT dhe të ULLINJVE TË ULQINIT E TË

TIVARIT. PËRPJEKJET E JUAJA, PËR TË MBAJTUR TË GJALLË

REVISTËN TONË "BUZUKU" JANË HOMERIKE. KU JU PA ASNJË

PARAGJYKIM, PO PUNONI FUQISHËM PËR TË EDUKUAR NJË

BREZ TË RI, ME TRADITAT E HERSHME, PATRIOTIKE,

KULTURORE, ARTDASHËSE dhe ATDHETARE. JU PO EVIDENTONI

FIGURA TË SHQUARA TË GJITHË TREVËS KU JETOJNË SHQIPTARË,

NË MAL TË ZI E DERI NË HAPËSIRAT MBARË SHQIPTARE. KËTË E KANË

PARË, NË JANINË, FILAT, IGOMENICË, DODONË, ARTË e PREVEZË,

POR EDHE NË KORFUZ, KU KAM DËRGUAR REVISTËN TONË TË NDERUAR,

TË CILËN MA KANË FOTOKOPJUAR ME DHJETËRA KOPJE, PO KËSHTU EDHE

NË SELANIK e ATHINË. NË TAKIMIN PËRKUJTIMOR, QË U MBAJT NË TIRANË

PËR STUDIUESIN HERO, TË PA HARRUARIN ARISTIDH KOLA, PELLAZGOLOGUN,

E SHQUAR ARVANITAS, QË KISHTE DËSHIRË TË VINTE NJËHERË EDHE NË ULQIN,

PËR T'U TAKUAR ME JU, PARA DHJET VITEVE, POR ISHTE E PA MUNDUR. NË NJË

LETËR, QË AI ME SHKRUAN, VLERËSON PUNËN E SHKËLQYER TË Dom SIMON FILIPAJT

SI PËRKTHYES I BIBLËS NË GJUHËN SHQIPE, KONTRIBUTIN e Dom Dr. VINÇENC MALAJT,

PËR THEMELIMIN E SHOQATËS "DON GJON BUZUKU" - 1995, në ULQIN. E ME THOSHTE:

"..... A thua, një ditë edhe unë, me arvanitasit e shquar të Athinës, do ta bëjmë një

Shoqatë, me emrin "PELLAZGU i ATHINËS" e në JANINË NJË GAZETË ME EMRIN "PELLAZGU

I DODONËS" E sa dëshirë të madhe që kam." POR ATË E ZHDUKEN ANTI-SHQIPTARËT.

POR JO VEPRËN dhe STUDIMET E TIJA, PËR GJUHËN SHQIPE E CILA RRJEDH PREJ PELLAZGJISHTËS.

DUKE PËRFUNDUAR, JU DËRGOJ URIMET E MIJA MË TË PËRZEMËRTA, PËR PUNËN TUAJ SA SERIOZE

AQ EDHE PATRIOTIKO - INTELKTUALE, ME KAQ SHUMË AKTIVITETE, SA JU KA ZILI EDHE NJË

INSTITUCION I SPECIALIZUAR SHKENCOR, JO VETËM NË MAL TË ZI, POR EDHE NË SHQIPËRI, KOSOVË,

MAQEDONI, E NË USA. ME KËTË RAST, JU PËRGËZOJ PA MASË TË GJITHË REDAKSINË TUAJ, KRYEREDAKTORIN

E SHQUAR Zt. SIMË GJON DOBRECIN dhe zëvendësin e tij, Zt. GJEK GJONAJ, si dhe PUNËN TUAJ ME Zt. GAZMEND

ÇITAKUN, QË E KENI KOMPOZUAR ARTISTIKISHT, NË NJË NIVEL TË LARTË SHKENCOR dhe KUALITATIV.

SHUMË TË FALA TË GJITHËVE.

ME SHUMË RESPEKT

Prof. GËZIM My. URUÇI - EUROETNOLOG

PRESIDENT I FORUMIT INTELKTUAL SHQIPTAR

SHKODËR, më 24.12.2010.

Me rastin e festave të fundvitit

(Shkodër, më 24.12.2010)

Sender: gezim_uruçi

<profuruçi@gmail.com>

Recipient: fdobreci@t-com.me

On Fri, 24 Dec 2010 03:45:20

+0100, wrote:

BURRNESHAT SHESTANESHA ME GËRSHETA SI ENGJËLLUSHET E VËRTETA BURRAT SHESTANAS ME PLISA JANË SI LISA

Shkruan Nikë Palkola (e-mail shpirt1946@yahoo.com)

Me gzime festimi i pesëmbëdhjetë vjetorit të Shoqatës "Dom Gjon Buzuku" dhe interpretimi i valles së Shestanit. Urimet, falënderimet dhe mirënjohjet e mija me gjithë mendje, vetëdije dhe me gjithë shpirt! Po, Shestani, burrneshat shestanesha dhe burrat shestanas kanë qenë, janë dhe do të jenë!

Të gjithë shestaneshave dhe të gjithë shestanasve që jetojnë në trojet tona dhe atyne në gërbet u dëshiroj gjithë të mirat e mundshme të kësaj bote! Gjithashtu njajtë u dëshiroj atyne që e udhëheqin Shoqatën "Buzuku", si dhe atyne të redaksisë të revistës "Buzuku", të udhëhequn nga Simë Dobreci dhe Gjekë Gjonaj.

Uroj edhe ata që përgatitën programin dhe pjesëmarrësit në program! Kur e pashë në atë veshje, për mu të shenjtë, dhe e ndigjova Markun e Niks Markut Nik'Tags - Tagaj, që aq bukur i ra fyellit, dhe valltarët e valltare të interpretun vallen e Shestanit aq të vjetër qysh në kohën e ilirëve (siç asht edhe gërsheti), u mallëngjeva shumë! Shestani nuk asht vetëm në ato male ku quhen Shestan. Shestani asht gjithku në këtë Planet ku ka shestanas e shestanesha.

Shestani asht në mendjet, vetëdijet dhe në shpirtinat e shestanasve dhe shestaneshave. Po tham me krenari modeste se stërgjyshja ime ka qenë nga Nilajt e Ljares. Edhe në mendjen, vetëdijen dhe në shpirtin tim asht Shestani.

Shestanasit kurrë nuk janë largu shumë prej vendit vet, e as prej amaneteve e gjaku i të parëve edhe pse prej katrahurave të ndryshme nga pak janë

largu si të gjithë tjerët, por kur e pashë vallen pata ndjenjën se jo vetëm që shestanasit i janë afru gjakut e amanetit të t'parëve, themeleve e votrave të Shestanit por edhe lashtësisë së vet. Kjo asht aq e mrekullushme saqë nuk



di ta përshkruaj! Më mbetet vetëm të përulëm me respekt para jush, t'ju falënderoj dhe t'u jam mirënjohës përjetë!

E di se do të vazhdoni të neroni të parët tuj dhe vetvedin! Kur të duhemi me njani tjetrin, të nero-hemi, të tolerohemi, të solidarizohemi dhe të bashkëjetojmë në harmoni, e bekojmë vedin, rrethin dhe mandej edhe Zoti do të na bekojë! Nji ndër vetitë e virtytet e shqiptarëve ka qenë me i dashtë, me i neru, me u kujdes për pleq, me e nigu fjalën e tyren.

Kur revistën "Buzuku" e kemi në dorë kemi edhe shpirtin e Madh të Shestanit e të parëve tonë, kemi shpirtin e përbashkët iliro-shqiptar, dhe të bashkum me shpirtin e sotëm të burrneshave e burrave shestanas e shestanesha, dhe të rejave, të rinjve dhe të fëmijve shestanas dhe ma gjanë. Edhe njëherë urime për pesmbëdhjetë vjetorin e Shoqatës "Buzuku"! Zoti i bekoftë shestaneshat dhe shestanasit!

Nju-Jork, më 01.12.2010.

Kalaja e Samoborit - vendbanim ilir

Shkruan Anton Lulgjuraj, arkeolog

Pranë kufirit shtetëror të Malit të Zi dhe Shqipërisë, në perëndim të Liqenit të Hotit, në pjesën veriore të Liqenit të

dallohen tre faza ndërtimi: e para në periudhën e hekurit, e dytë në kohën e mbretërisë ilire dhe e treta në periudhën romake. Nga këtu, shihet me sy Kodra e Moksetit në lindje të Liqenit të Hotit në

izoips më sipër, ndersa lugu vetë ndahet permes me një linjë e drejtë muri. Në tërë sistemin duket një lloj pune më e kujdeshme sesa në kalanë e Gajtanit. Sistemi fortifikues ka gjatësi rreth 200 m dhe gjerësinë më të madhe 90-100 m. Më mirë është ruajtur këndi juglindor i fortifikimit, ku një trakt i vogël muri rrethues qëndron ende në këmbë mbi 2 m lartësi. Sa i takon teknikës së ndërtimit, blloqet e gurëve janë lënë siç kanë dalë nga gurorja, herë me forma kuadratik, blloqet me gjatësi deri 1.60 m, lartësi 0.60 m dhe thellësi 1 m. Kishte blloqe ndonjëherë edhe me shumë kënde, të vënë njëri mbi tjetrin pa ndonjë kujdes të veçantë. Hapësirat midis gurëve janë mbushur me gurë të vegjël. Për shtresa të rregullta nuk bëhet fjalë, se paku në traktet e ruajtura, që natyrshëm formojnë pjesën e poshtme të murit.

I rrethuar në tre anët nga liqeni, i vendosur në dy majat e kodrës dhe i rrethuar me mure të forta, e bënte Samoborin një fortesë të fuqishme dhe jo të lehtë për tu pushtuar, çka banorëve të saj u siguronte strehim të qetë gjatë luftërash, si dhe dalje në liqe. Rruga kryesore e afërt siguronte ekonomi të zhvilluar. Ky vendbanim do të ketë gjallëruar prej periudhës së hekurit e deri në kohën e Bizantit, për më tepër se 1000 vjet.

Vetëm gjurmimi sistematik do të na qartësonte më shumë pamjen e këtij vendbanimi të rëndësishëm në basinin e Liqenit të Shkodrës



Pjesë e murit jugor të kalasë



Shkodres, midis fshatit Bozhaj dhe Ploçë, jo më larg se një kilometër në veri të saj ndodhet burimi i Vitojës. Më 10.12.2010, vizitova një kodër të ngritur përmbi Liqe, e cila në periudhën e vet historike do të ketë shërbyer për vendbanim të përshtatshëm për peshkim, si dhe për kontrollimin e rrugës që vinte nga veriu për në Shkodër. Mungojnë të dhënat arkeologjike dhe burimet e shkruara për këtë qendër të vogël mbi Liqenin e Shkodrës. Kjo më së shumti njihet nga studiuesit austriakë Kamilo Prashniker dhe Arnold Shober, të cilët, gjatë shtetitjes së tyre para një shekulli, i zbuluan dhe të parët i shënuan disa të dhëna për rrënojat e këtij vendbanimi.

I vendosur në vend shumë strategjik i cili kishte për detyrë kontrollimin e rrugës më rëndësi, e cila në antikitet lidhte qytetin e Shkodrës me territoret ilire në veri, dhe me ardhjen e romakëve po këndej kalonte rruga nga Naronë e Dalmacisë për në Duklea (Dukla) dhe prej këtu në Shkodër, e cila ishte e një rëndësie jo vetëm për këto qytete me rrethina por për gjithë provincën e Ilirikut. Disa studiues e vendosin pikërisht këtu stacionin rrugor Birzimnio të periudhës romake, duke marrë për bazë itineraret (shënim rrugësh) romake të cilat e paraqesin në largësinë prej 30 miljesh romake nga Shkodra. Por kjo duhet të vërtetohet sepse ka mendime se Birzimnio mund të ndodhet në fshatin e sotëm të Vuksanlekajve.

Nga teknika e punimit të mureve

Shqipëri, ku, si mbas gjurmimeve të Gëzim Hoxhës, në këtë vendbanim vërehen dy fazat e para të ngjashme si në Samobor. Edhe ky vendbanim ilir kishte funksion të njëjtë të rëndësishëm, mbrojtjen e shtegut të kalimit për qytetin e Shkodrës.

Vendbanimi Samobor është shtrirë në dy maja të kodrës të drejtura nga liqeni, ku, është e besueshme, ndodhej akropoli, përderisa për banim është përdorur terreni me poshtë i ndarë me një mur nga akropoli. Gjetja e monedhave të Shkodrës, Apolonisë, Dyrrahionit dhe Korintit, të prerë mes viteve 225-100 p.e.r., pak fragmente të qeramiks të gjetur në të gjithë sipërfaqen e kodrës apo vendbanimit, për të cilat, në mënyrë të përgjithshme mund të thuhet, se i përkisnin importit të mallit grek për afërsisht rreth mesit të shek.III p.e.r.

Në thelb, është ruajtur vetem muri rrethues i kalasë, por edhe ky, pavarësisht se linja e tij është e qartë, vende-vende është zhdurur plotësisht në distanca të gjata. Muri mbrojtës rrethon dy majat dhe lugin mes tyre në një planimetri pak a shumë eliptike. Në vendet ku janë të thikëta, muri është i vendosur në një



Fisnikja shqiptare bashkëshorte e themeluesit të Cetinjës

Prof. Shyqri Nimani, Prishtinë*

Familja sunduese e Cërnojeviqëve përmendet për herë të parë në shekullin XIV, anëtarët më të rëndësishëm të së cilës ishin: Stefani (1426-1465), Ivani (1465-1490) dhe Gjergji (1490-1496). Me pushtimin osman të Cetinës, më 1499, kryeqyteti i Zetës përfshihet në Sanxhakun e Shkodrës, kur edhe përfundon sundimi i Cërnojeviqëve.

Familja e Cërnojeviqëve një kohë të gjatë luftoi kundër Balshajve¹, sundesve të fuqishëm shqiptarë.

Një lidhje martesore bëhet edhe ndërmjet familjes së njohur fisnike shqiptare Komneni dhe asaj Cërnojeviq. Çifti bashkëshortor do të bëhet Ivan Cërnojeviq dhe Nora Komneni, e bija e sundesit të Shqipërisë Jugore – Aranit Komnenit.

Ivan Cërnojeviq zë vend të rëndësishëm në historinë malazias. Ai ishte themelues i Cetinës (1481), kryeqytetit të shtetit Zeta². Ivan Cërnojeviq ngriti një manastir në stilin renesansogotik (që është një kuriozitet) dhe një kishë të vogël. Supozohet se në shtypshkronjën e këtij manastiri është botuar libri i parë i shtypur, inkuanabulik – Oktoih (1494) në alfabetin cirilik në jugun sllav.

Më 1986, gjatë gërmimeve arkeologjike, ekipi i Entit për Mbrojtjen e Përmendoreve të Mali të Zi zbuloi eshtrat e sundesit të Zetës (Mali të Zi) dhe themeluesit të Cetinës, Ivan Cërnojeviqit – pesë shekuj mbas vdekjes së tij. Eshtrat u gjetën në kishën oborrtare të Cetinës, nën pllakat e dyshemesë që gjendet pranë ikonës së Krishtit Shpëtimtar në altar. Ndërkaq, asgjë nuk u kumtua për eshtrat e bashkëshortes së tij, Norës. Sepse, të dhënat flasin se Ivani ishte varrosur në themeltën e vet të përsipirtshme së bashku me të shoqen. Këtë e pohan



Cetinë - manastiri

edhe historiani malazias, Sava Vukmanoviq, duke thënë: “U istoj crkvi sahranjena je i Ivanova žena, po narodnoj pjesmi Nara, a po istoriji Gojislava, k erka Arvanita Komnena, gospodara Južne Albanije”³. Kështu pohonte edhe poeti Jovan Sundeçiq, i cili ndër tjerat thoshte: “...gde su bile

Kush janë Cërnojeviqët

N'kohën e Jugosllavisë mretnore (1918-1941), n'Ulqin ka jetue një plak shkodran i kshtenë, qi për veti thonte se isht Zezali*. Ju luta t'm'thonte se kush janë Zezalitë. Aj u përgjegj: Po, Zezalitë janë ata qi Malazezët ju thonë Cërnojeviq.

*Edhe tash ka familje Zezaj të krishterë në Shkodër
Tregoi Gjoni Niks Kol'Niks Pjetër Gjonit Gjergj Gjonaj-Dobreci (1899-1977), Braticë, Ulqin.
Shënoi Sima, i biri, më 1970. Marrë në BUZUKU 31/2009:11.

sahranjene kosti Ivanbegove i Ivanbegovice”⁴. Deri tash nuk kemi hasur në të dhëna të tjera, as në burimet shqiptare, e as të huaja, që do të ndriçonin sadopak figurën e fisnikes shqiptare Nora Komnenit – zonjës së parë të kryeqytetit të Zetës mesjetare, Cetinës.

Nga ana tjetër, ende mbetet e paqartë cili prej Arianitëve ishte ati i Norës, kur dihet se nga kjo familje e njohur feudale shqiptare nuk shfaqet vetëm një personalitet me emrin Arianit Komneni. Vallë, mos është fjala për trimin Gjergj Arianit Komnenin (bashkëluftëtarin dhe mikun e Skënderbeut), për të cilin K. Jeriçek thotë se ai kishte edhe një emër e mbiemër: “Arnit Spata të cilin grekët e quanin Arijanit Komnen”. Pa përgjigje mbeten edhe disa pyetje që kanë të bëjnë me një letër të zbuluar para ca vitesh në arkivin e një manastiri të Meteorës (Greqi), të shkruar sllavisht në kancelarinë e Arianit Komnenit; letra nuk ka datë, nuk shënon emrin e personit që i dërgohet...por jep vetëm emrin e dërguesit – Arianit Komnenit.

1. Balshajt, siç dihet, ishin familje e madhe feudale e Shqipërisë së Veriut, të cilët sunduan prej vitit 1360 deri në 1421 në Principatën e Shkodrës, në të cilën arritën të bashkojnë deri më 1385 një pjesë të madhe të trevave shqiptare. Përfaqësuesit kryesorë të tyre ishin: Balsha I (deri më 1362) dhe tre djemtë e tij Strazimiri (deri më 1372), Gjergji I (deri më 1379) dhe Balsha II (deri më 1385), pastaj Gjergji II Strazimiri (1385-1403) dhe Balsha III (1403-1421). Balshajt, duke përdorur forcën, aleancat dhe lidhjet martesore, sundonin Zetën, Shkodrën, Tivarin dhe Buduan.

2. Zeta u themelua në hapësirën që në lashtësi quhej Dioklea, qendër e fisit Ilir të Dokleatëve, për t'u shkatërruar nga sllavët në shekullin VII, pastaj për t'u përfshirë në shtetin serb të Rashës në shekullin XIII e deri në vdekjen e Stefan Dushanit (1355), që, së fundi, nga pushtimi osman e këtej të pagëzohet me emërtimin Mali i Zi.

3. Në kishën e njëjtë është varrosur edhe gruaja e Ivanit, si mbas këngës popullore Nara, ndërsa si mbas historisë Gojislava, e bija e Arvanit Komnenit, kryezotit të Shqipërisë Jugore.

4...ku kanë qenë të varrosura eshtrat e Ivanbegut dhe të Ivanbeges).

*Marrë prej KOHA DITORE nr 300, 15.IV.2006.

Cetinë - shihet edhe manastiri



Plotësim për Zezali - Cernojeviqë

Shkruan Prof. GËZIM My. URUÇI,
euroetnolog, Shkoder

Shume i nderuari miku im Zt. DOBRECI!
Për sa i përket familjes "ZEZAJ" ato janë disa, që gjurmët e tyre shkojnë në thellësi të mistereve të mesjetës së hershme. Vendbanimet e tyre janë për rreth Kalasë së Danjës, në Vaun e Dejës, shumë afër qytetit të Shkodrës. Gjatë pushtimit Venedikas, ato lozin një rol në jetën e bashkësisë së Danjës. Pas pushtimit të egër, ato futen në thellësi të maleve, dhe një pjesë e tyre kaluan në thellësi të kanionëve të lumit të Zezajve (Zetës) dhe nga këtu në drejtim të Lumit që sot quhet Rieka Cernojeviq. Pasi instalohen në këtë grykë, ato kalojnë sipër, në një gropë që quhej QETIN (Cettin), vend me pisha, bjeshkë, vend i qetë, që pas pushtimit sllav, mori emrin Cetina, në latinisht Cettina, emër që gjendet edhe sot në rajonet e Kalabrisë, ku mund të përmend edhe mikeshën time, kolegen e etnologjisë Znj. Cettina Mazzei (me këtë emër shif në Facebook). Këtu më vonë u themelua një vend banim tjetër EREMIT, me prejardhje sllave.

Legjenda thotë se ZEZAJT u larguan për arsye të gjakmarrjes, sa të gjithë u veshën me të zeza. I ruajtën marrëdhëniet me trojet e tyre. Këtu duhet theksuar edhe shumë të dhëna të tjera në lidhje me historinë e këtyre familjeve.

1. Gjergj Kastrioti Skënderbeu - ven kurorë në Kishën e Vaut të Dejës.
2. Mara*, motra e Gjergj Kastriotit Skënderbeut, martohet me Stefan Cërnojeviqin (ZEZALINË); ajo e ka varrin në ishullin Kom (Liqeni i Shkodrës, afër Zhabjakut). Pra këto nuk janë rastësi, por të dhëna që përforcojnë "legjendat" e banorëve të zonave shqiptare (në Shqipëri). Sot ka shumë familje Zezaj, ku pjesa më e madhe janë të besimit katolik, por ka edhe myslimanë, të cilët dëshmojnë prejardhjen e tyre katolike. Duke parë edhe mentalitetin se mbiemri Zezaj ngjallë keq, tendencat janë për ta ndërruar, kundrejt një takse të vendosur nga Shteti Shqiptar. Një pjesë e madhe e këtyre familjeve sot kanë marrë edhe mbiemra të rinj, si Burimi, Plepi, Rruga, Vneshta etj. Zezalitë përmenden edhe në folkun e Shqipërisë së veriut.

Duke perfunduar, ju uroj te gjitha te mirat. Me shume respekt,

Prof. GËZIM My. URUÇI - EUROETNOLOG
Shkoder, më 9 Janar 2011

*Po na del që në familjen e Cërnojeviqëve ishin të martuara dy fisnike shqiptare, Mara Kastrioti dhe Nora Komneni, bijat e dy sundesve të njohur shqiptarë, Gjergj Kastriotit Skënderbeut dhe Aranit Komnenit. Pra, nuk mund të mos besohet, që shqipja ishte gjuha kryesore e familjes së Cërnojeviqëve, Zezalive (Zezajve) të Malit të Zi.

Shih edhe M.E.Durham, Për fiset, ligjet e zakonet e ballkanasve (Cernojeviçët), 'Arbëria' Shkodër 2009:53-7.

Përgatitë S G J D

Për valle e veshje të Shestanit

TV1 Channel, Shkodër

Me rastin e 15 vjetorit të krijimit të Shoqatës "Gjon Buzuku" në Ulqin, më 20.11.2010, është mbajtur koncerti festiv, ku u promovuan veshjet dhe vallet e trevës së Shestanit. Këngët karakteristike dhe veshjet e grave dhe burrave, të cilat janë ndër më të veçantat në Ballkan, treguan për një histori të lashtë të kësaj zone, e cila ka qenë më e rrezikuara ndaj asimilimit dhe mërgimeve të ndryshme.



Doktor Simë Dobreci, studiues dhe njohës i mirë i traditës dhe kulturës së Shestanit, shprehet se pushtuesit çdo herë kanë favorizuar asimilimin dhe kanë ndikuar negativisht në traditën tonë. Veshja e Shestanit është karakteristike. Ajo për rininë e kësaj zone ka një domethënie të madhe për

ruajtjen e traditës, të identitetit kombëtar dhe të historisë së trevës së Shestanit.

Vallet dhe këngët e Shestanit datojnë që nga kohërat e hershme, tradita tregon se këto janë ruajtur brez mbas brezi. Gratë e burrat të kapur njëri për tjetrin krijojnë vallen në trajtë të rrethit, sillen në drejtim të djathtë dhe këndojnë pa muzikë.

Këto veshje janë hulumtuar në Shestan, në Ljare, Pinç dhe në Thtjan (pjesa perëndimore e Krajës, jugperëndimi i Liqenit të Shkodrës, në territorin e Malit të Zi). Veshja dimërore përbëhet nga këmisha e bardhë, përparësja "boçja", guna "zhgunji", xhamadani prej zhgunji. Përparësja "boçe" ishte me katrorë me ngjyrë të kuqe dhe të bardhë. Guna "zhgunji" endej në vek prej zhgunji të bardhë. Ajo zbukurohej me gajtanë shumëngjyrësh. Në pjesën e përparme, xhamadani kishte nga dhjetë sumbulla (pulla) prej argjendi, të punuara me teknikën e petëzimit dhe me filigran.

Në shpinën e xhamadani, paraqitej motivi i skematizuar i gjarprit në formë të spirales si dhe motivi i rathëve. Në zbukurime mbizotëronte motivi i trekëndëshave. Në bel vinin brezin prej leshi. Në kokë vinin "gërshet-in" dhe tri "tufa" prej mëndafshi, të cilat kapeshin me një "gjysmëshami" të kuqe, mbi të cilën vinin shaminë e bardhë. Studiuesi Dr. Simë Dobreci tregon se kjo veshje e bardhë daton që në periudhën Ilire dhe si e tillë sqarohet përmes veshjes së bardhë dhe të hulumtimeve arkeologjike në ndonjë skulpturë sepse është shumë e vështirë të gjendet literaturë për veshjen e Shestanit.

Treva e Shestanit është një nga zonat më karakteristike Shqiptare në territorin e Malit të Zi, emigrimet e ndryshme të kësaj treve drejtë Zarës (Zadrës) së Kroacisë, ku edhe sot njihen si Arbreshët e Zarës (Arbanasi), drejte Tivarit, Ulqinit, Shkodrës dhe vendeve të ndryshme të botës, kanë bërë që ky komunitet të bie pre e asimilimit, veshja dhe ruajtja e traditës me fanatizëm ka qenë ndër ndikuesit kryesor që populli i kësaj krahine të mos asimilohet plotësisht. Në trevën e Shestanit supozohet se është shkruar edhe libri i parë në gjuhën shqipe, "Meshari" i Gjon Buzukut, pasi nga të dhënat rezulton se në këtë kohë ai të ketë qenë famullitar në këtë trevë.

Shkollimi shqip në komunën e Plavës

Shkruan Shaban Hasangjekaj, Martinaj, Guci

Arsimi fillor shqip në territorin e komunës së tashme të Plavës ka filluar menjëherë mbas Luftës II Botërore, kur me iniciativën e entuziastëve të atëhershëm shqiptarë të etur për dritë e dituri në gjuhë amtare, edhe përkundër rezistencës së fortë nga pushteti i atëhershëm i ngurtë, u hapën paralelet e para me mësim në gjuhën shqipe.

Kështu, në vitin shkollor 1945/46, në fshatin Vuthaj u hap paralelja e parë me mësim shqip, ku mësuesi i parë ishte Ahmet Rexhepagiqi prej Plave. Një vit shkollor më vonë, hapet edhe në fshatin Martinaj, ku mësuesi ishte pishtari i parë i arsimit shqip nga ky fshat, Jusuf Sylë Balidemaj. Ndërkohë, edhe në shkollën fillore të Gucisë hapën paralelet e para shqip të klasave të ciklit të lartë, të udhëhequra nga mësimdhënësi Ragip Abdurrahman Rexhepagiqi nga Plava. Procesi mësimor në shkollat e hapura shqip në Vuthaj dhe Martinaj është zhvilluar në lokalet e shtëpive private. Madje në Vuthaj, deri në ndërtimin e godinës shkollore, mësimi është mbajtur edhe në karakollën e ushtrisë. Në të dy shkollat e porsahapura, mësimi zhvillohej në dy ndërrime për shkak të numrit të madh të nxënësve (në Vuthaj mbi 90, në Martinaj mbi 50), që vijonin mësimin në klasën e parë (mosha prej 7 – 12 vjeç). Edhe përkundër kushteve të vështira (pa inventar dhe mjete të



nevojshme për punë), entuziazmi e vullneti e mundësuan që të punohej pa pushim gjithë ditën me zell, përkushtim dhe përpikëri. Deri sa në Vuthaj ca vjet më parë u ndërtua godina e shkollës me vetëkontribut, në Martinaj objekti që ishte ndërtuar për nevojat e kooperativës bujqësore në kohën e reformës së atëhershme agrare, u shndërrua në godinë shkollore, ku mësimi shqip dhe serbo-kroatisht është zhvilluar prej vitit shkollor 1954/55 e deri më 1997/98, kur mu në themelin e saj është ngritur shkolla e re, në të cilën edhe tani mbahet mësimi vetën në gjuhën shqipe. Edhe në Vuthaj u bë gati objekti i ri për vitin shkollor 1979/80.

Nxënësit nga Vishnjeva dhe Hoti, dy

fshatrat tjera të komunës së Plavës të banuara me popullatë shqiptare, ndiqnin mësimin në gjuhën serbo-kroate në Vojno-Sellë dhe Krushevë deri që u hap shkolla shqipe. Në Vishnjevë, paralelja e parë me mësim shqip është hapur në vitin shkollor 1968/69. Mësimi është zhvillua në lokalitë të një shtëpie të këtushme private, ku rreth një muaj e mbajti mësuesi Mehmet Ramë Balidemaj, deri që u pranua mësuesi i ri i përhershëm, Rexhep Bali Balidemaj, i cili për disa vite punoi në edukimin dhe arsimimin e vogëlusheve të këtij fshati, si dhe të dy fshatrave fqinje, Hakaj e Krushevë (lagja Kukaj), që në të rregullisht i vijnë mësimet.

Ndërkaq, në Hot paralelja e parë në gjuhën shqipe u hap në vitin shkollor 1970/71. Mësimin e zhvilloi mësuesja nga Vuthajt Dushe Ramë Gjonbalaj në një shtëpi private në Hot 3 vite shkollore. Mandej u kalua në fshatin fqinj Jasenicë, po ashtu në shtëpi private, deri që u ndërtua shkolla e re në Hot (gjysmë vjetori i dytë i vitit shkollor 1974/75). Mirëpo, për shkak të shpërnguljeve dhe emigrimit të familjeve nga ky fshat dhe fshatrat fqinje Zabel dhe Jasenicë, u pakësuan edhe nxënësit dhe shkolla u mbyll mbas përfundimit të vitit shkollor 1987/88. Pesë vjet më vonë, me iniciativën e entuziastëve shqiptarë, kryesisht atyre që kanë jetuar në Hot, Zabel dhe Jasenicë, e tash banonin e punonin në Plavë dhe rrethinë, të etur që fëmijët e tyre të mësojnë në gjuhën amtare si më

Nxënës të ciklit të ulët - Guci, me mësuesen Sehada Shabanoviqi dhe mësuesin Shaban Hasangjekaj



parë gjatë 18 vjetëve në shkollën e Hotit, Ministria e arsimit dhe shkencës të Malit të Zi dha pëlqimin në kërkesën

politike, numri i nxënësve me mësim shqip në shkollat fillore të Gucisë, e cila në vitin 1962 me vendimin e pushtetit të

shkollat fillore 9-klasëshe në Plavë e Guci dhe në 3 shkollat e ndara 4-klasëshe (Vuthaj, Vishnjevë dhe Martinaj) mësimet i ndjekin 254 nxënës (prej tyre 218 në shkollën e Gucisë të sistemuara në 14 paralele mësimore të ndara, kurse 36 nxënës në shkollën fillore të Plavës të sistemuara në 2 paralele mësimore).

Në shkollën fillore të Gucisë, që është bartëse e mësimit shqip në komunën e Plavës, ku qe 6 vite shkollore po aplikohet reforma e re shkollore 9-vjeçare, në klasat e ciklit të lartë (V-IX) mësimin e ndjekin 128 nxënës në 8 paralele mësimore, kurse në ato të ciklit të ultë (I-IV) – 21 nxënës në 2 paralele të kombinuara mësimore më nga 2 klasë. Në të gjitha shkollat fillore 4-klasëshe në fshatra punojnë nga 2 paralele mësimore me nga 2 klasë të kombinuara (Vuthaj 26 nxënës, Vishnjevë 18, Martinaj 25). Në shkollën fillore 'Hajro Shahmanoviç' të Plavës mësimet shqip i ndjekin 36 nxënës në 2 paralele të kombinuara me nga 2 klasë.

Së numri i nxënësve po zvogëlohet pa ndërpre e dëshmon regjistrimi i fillestarëve në klasën e parë, gjithsej 25 (në Plavë 10, Guci 6, Vuthaj 3, Vishnjevë 4, Martinaj 2). Krahasuar me vitin shkollor 1974/75, numri i nxënësve këtë vit shkollor është 46.18% më i ultë. Në këtë vit shkollor në komunën e Plavës mësimin shqip e zhvillojnë 10 profesorë, 4 arsimtarë dhe 3 mësimdhënës të pakualifikuar.

Mbas kryerjes së shkollës fillore në Guci, nxënësit kryesisht i vijnë mësimet shqip në shkollën e mesme të përzier 'Beqo Bashiqi' në Plavë (29 nxënës në 4 paralele në gjimnaz dhe 2 në drejtime profesionale).

Më 07.02.2011.



Vallëtarët e shkollës - Guci

e tyre, që pranë shkollës fillore 'Hajro Shahmanoviç' të Plavës të hapet paralelja me mësim në gjuhën shqipe. Në këtë shkollë, në vitin shkollor 1993/94, fillon mësimi shqip, i udhëhequr nga arsimtarja e mësimit klasor Xhufe Hasan Vuçeta, e fshatit Vuthaj. Paralelja e pandarë me 4 klasat kishte 23 nxënës, 12 prej tyre në klasën e parë.

Mësimin shqip në klasat e larta të fillores nxënësit e kanë ndjekur në shkollën fillore të Gucisë deri në fund të vitit shkollor 1955/56, kur me vendimin e regjimit të pushtetit të atëhershëm shtetëror, ndërpritet në Guci e Martinaj (jo në Vuthaj), për t'u rihapur mbas 3 vjetëve (më 1959/60). Gjatë kësaj kohe fëmijët shqiptarë nga Martinajt u detyrua që prej klasës së parë mësimin ta ndjekin në gjuhën serbo-kroate, kurse në klasat e larta edhe ata të fshatit Vuthaj. Ndërprerja e mësimit shqip në Guci e Martinaj krijoi pakënaqësi te prindit, si dhe fëmijët të cilët disa e ndërprejnë mësimin në klasa të larta.

Rihapja e mësimit shqip në klasat e larta në shkollën e Gucisë karakterizohet me ardhjen e 3 mësimdhënësve të diplomuar në Kosovë në shkollat normale, Ramadan Gjonbalaj, Ramë Qosaj dhe Hysën Novaj, të cilët me zell dhe vullnet iu përvishen edukimit dhe arsimimit të vogëlushëve kureshtarë, të cilët mbas kryerjes së fillores, të gjithë vazhduan mësimet në gjuhën shqipe në shkollat e mesme në qendrat e ndryshme në Kosovë.

Deri në filltet e viteve 1980-ta, kur fillon emigrimi i familjeve shqiptare në botën e jashtme (kryesisht në SHBA, Evropën perëndimore, nëpër mbarë botën), për shkaqe ekonomike por edhe

atëhershëm merr emrin e revolucionarit gucjan Xhafer Nikçeviqit, të cilin e mban edhe tani, dhe në tri shkollat katërklasëshe paralele të ndara të saj në Vuthaj, Vishnjevë e Martinaj, si dhe në shkollën katërklasëshe të Hotit, paralele e ndarë e shkollës fillore të Plavës, numri i nxënësve për çdo vit shkollor ka qenë në rritje. Për shembull, në vitin shkollor 1974/75, në klasat e larta me mësim shqip në shkollën e Gucisë mësimet i kanë ndjekur më se 260 nxënës (prej tyre rreth 70 vajza, 17 në klasën e tetë). Në të njëjtin vit shkollor, në klasat u ulëta të fillorës (Vuthaj, Vishnjevë, Martinaj, shkolla amë në Guci dhe në Hot) mësimet i kanë ndjekur rreth 290 nxënës. Prej viteve 1980-ta, numri i nxënësve në të gjitha shkollat e përmendura prej vitit në vit është gjithnjë më i vogël. Kjo është një brengë e madhe, preokupim i të gjitha strukturave të popullatës shqiptare në komunën e Plavës, që po trajtohet në shumë takime, tubime, simpoziume, tryeza të rrumbullakëta, ku po kërkohet zgjedhja pozitive sa më e shpejtë.

Se numri i nxënësve në shkollat fillore me mësim shqip në komunën e Plavës është në rënie e dëshmon ky vit shkollor (2010/11) : në dy



Shkolla - Guci

Vallja e Shestanit në Shkodër

Shkruan

Gëzim My. Uruçi*

Perla e mbrëmjes artistiko-festive me rastin e 100 vjetorit të ngritjes së flamurit tonë kombëtar në majën e malit Deçiq, nga kryetrimi legjen-

*njerëzimit..”, pat thënë Prof. dr Ramadan Sokoli, akademik - muzikolog**.*

Dhe s'ka si të jetë ndryshe edhe në këtë mbrëmje madhështore të organizuar nga Shoqata Kulturore “KENGA e

Me ra pika n'lule t'ballit,
Nдалu pak te baj sejra! .. etj.

Dhe shfaqja fillon me lahutarin e shquar Pretash Nilaj, duke vijuar me përkujtimet për kolosët e artit e të kulturës shqiptare, Angjelin Perlocajn, Luk Kaçaj - Nderi i Kombit, Ramadan Sokolin - Mjeshtër i Madh e Akademik, Gjellosh Gjokën - Piktur Akademik, Malotën - aktorin e Hollywood, Shtjefen Ivezajn - fotograf dhe Etnograf muzeolog i shquar, Besim Zekthin - kolosin e koreografisë Shqiptare, Ismail Lulanin - Artist i Popullit, Sali Manin - Bilbilin e Malesise Artist i Merituar, Nikoll Buçin e kanges Majekrahi e tjerë.

Ku nuk munguan perlat e melosit të folkut të Malësisë, të gërshetuar me një thesar të jashtëzakonshëm etnografik. Të sjellë me një vërtetësi të admirueshme, ku Çun Lajçi, Mjeshtër i Skenës, solli një dialog spektakular me qelshen e tij, plisin e bardhë si bora të Dardanisë, perlat e repertorit të rapsodit dhe drejtorit organizativ, të shfaqjes Rrok Gjellajt, këngët popullore të shquarës Mukades Çanga, Liri Rashës plot freski, Hana e Kolë Nikprelës, Ilir Shaqirit, Recitimi hyjnor i Yllka Mujos, Balada e Enkelejda Alushit, Selami Kolonja, nga Maqedonija, me kangën labe, Trijo e Malësisë. Instrumentisti virtuoz Fatos Mataj dhe të Pianistes Rudina Jakova, Ganimete Asllanit nga Mitrovica e Kosovës, Arben Delaj, Donika Vuçinaj, Skender Xhafës, Tonin Tershanës - Artist i Merituar, Humorin e Grupit “Filispanja”; si dhe përshëndetjet e grupeve të ndryshme si Grupi i Rapsodeve të Dukagjinit, Grupi i valltareve të Ansambllit të Shtetit, me solistë të shquar të koreografisë, Mjeshtrin e Madh Rexhep Çeliku dhe Artisten e merituar Liljana Cingu. Si

dar, heroi i popullit, Ded Gjon Luli, më 06 prill 1911.

Interpretim virtuoz ne skenën e teatrit “Migjeni” të Shkodrës, përpara presidentit të republikës së Shqipërisë, zotit prof. dr Bamir Topi.


*“Te nderuar studentë dhe pedagogë!
Historia e kulturës popullore shqiptare ka një gjeneze sa interesante aq edhe të dhimbshme. Pasi një pjesë e konsiderueshme e këtij folku dhe të etnografisë, gjendet në treva të tjera, në Kosove, Çamëri, Maqedoni e Mal të Zi...Dua t'ju kujtoj, që mos të harroni folkun tepër interesant përreth trevave të Liqenit të Shkodrës, të Tivarit, Ulqinit, Malësive të Hotit e të Grudës, Kelmendit matanë kufirit, Kuçit e të Piprrit, Trieshit, Traboinit, Vraninës, Milesshit, Deçiqit, Dinoshës, Shpuzës, Tuzit, Lekajve, e në veçanti folkun e jashtëzakonshëm të Krajës e për rreth Majës së Rumisë, ku fshehën thesaret e pa zbuluara të popullit tonë. Ku vallet e Shestanit, veshja e tyre, dhe mikpritja janë tepër homerike, me një kulturë materiale e shpirtërore, që atëherë këto treva quheshin Dardano-Ilire, pra të kohëve pellazgjike, kur në majën e Rumisë ishte tempulli i hyjnine pellazgjike të Hyperit themelues të*

JONE” me President z. Rrok Gjellaj, me rastin e 100 vjetorit të ngritjes së flamurit tonë kombëtar mbi Malin Deçiq, nga Krye trimi legjendar i Hotit dhe i gjithë Malësisë, Heroi i Popullit Ded Gjon Luli, më 06 Prill 1911. Në mes të një atmosfere të jashtëzakonshme dhe duartrokitjesh, të pranishmit priten në hollin e Teatrit “Migjeni” Presidentin e Republikës së Shqipërisë Prof. Dr Bamir Topi, ku ishte rreshtuar e gjithë trupa e Valltarëve të Grupit të Shestanit, dhe ai nga befasia thirri: “Ç’është kjo mrekulli!” Të gjithë shtatlatrë dhe me kostumet e tyre të mrekullueshme, si zanat e kreshnikët e Bjeshkës së Rumisë, e s'ka si të mos na shkojë mendja tek vargjet e poetit dhe kompozitorit popullor të shquarit Shkodran, Hetit të Molla Sylos, kur i këndonte Shestaneshes, një shekull më parë:

N'Pazar të Shkodre mori
flutur,
Shestanesh, moj
Shestanesh,
Porsi lulja n'Bjeshk
t'Rumis,
Si zoj Shkodret kenke
vesh.

Syni yt si elmazi,
Ç'i hap rrezet ne dyrnja,





Lautari Pretash Nilaj,
e shoqërojnë Malësorja dhe Shestanasi

dhe një prezantim prefekt të një çifti të përkryer aktoresh si Znj. Raimonda Marku dhe Artisti i Popullit Reshat Arbana, që i dhanë shfaqjes një frymëmarrje të re e rrjedhshmëri.

Me pas si një fllad koreografik që zbrat plot hare e aromë nga Bjeshka e Rumisë, për të përshëndetur këtë tubim mbarëkombëtar, futet në skenën prestigjioze të Teatrit "Migjeni" edhe Grupi i njohur tash ma i Valleve të Shoqërisë Kulturore Artistike "Gjon BUZUKU" me "Valle e Shestanit". Krejt skena mbushet me ngjyrat e mrekullueshme të kostumeve të valltarëve të Shestanit, duartrokitjet janë të stuhishme, sa edhe Presidenti i Republikës rrëmbehet nga kjo atmosferë aq e këndshme e plot gjallëri me lëvizje të përpikta e plot plastike koreografike, duke krijuar figura të mrekullueshme, me interpretimet e jashtëzakonshme të vajzave të kësaj trupe që i rrëmbej të gjithë, duke i dërguar në imazhet e valles Pirriko – Pellazgjike, si figurat e gdhendura ndër gurët Megalitike të lashtësive Homerike. Ku shumë specialistë të koreografisë, etnografisë dhe të folklorit dhanë mendime plot superlative për këtë trupë dhe drejtuesin e saj zotin Vladimir Saiti, kryesin e një punë të jashtëzakonshme me këtë trupë të mrekullueshme koreografike, që meritoi duartrokitjet e shumta të publikut artdashës shkodran dhe të Malësisë së Madhe. Por edhe të specialistëve, të cilët e vlerësuan si ndër vallet me të lashta të sjella deri me tash në skenën shqiptare, mbas Valles

pagane të njohur tash ma si "Valle e Ujku", që u prezantua në Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës në vitin 2004. Edhe kjo e vënë në skenë nga z. Vladimir Saiti dhe Shoqata "KËNGA e JONË".

Pas shfaqjes, Presidenti i Republikës zoti Prof. Dr. Bamir Topi, i falënderoi të gjithë pjesëmarrësit dhe akordoi shumë tituj e dekorata pjesëmarrësve. Në

takimin me disa drejtues të Shoqatës "DON GJON BUZUKU", ku merrnin pjesë zoti Zefi Gjonit Lucit Nojs-Kovaçi (Pema), Zef Rrok Lukiqi, Nikollë Dukagjini, Gjergj Rrok Pekaj, Pjetër Antoni-Marnikaj, Gjergj Pepgjoni, Nikë Luviqi-Pekaj, Lori Pals Leks-Lukiqi, Palë Anton Duraj dhe Valentin Zef Kovaçi, të cilëve, Mjeshtri i Madh i koreografisë Shqiptare, Artisti i Popullit, Besim Zekthi, ndër të tjera, u tha: "...Pashë një trupë me nivel dhe përgatitje të lartë koreografike, me një disiplinë të lartë skenike, dhe me një veshje befasuese, ku elementi

etnografik ishte i përsosur dhe në harmoni me atë koreografik. Të gjithë shtatlartë si heronjtë mitologjik të bjeshkëve tona. Ju ndoqa me shumë kënaqësi dhe me syrin e një specialisti, jeni me të vërtetë për t'u admirua, Ju që e interpretuar me shumë vërtetësi Vallen Perle të Shestanit dhe drejtues i Juaj zoti Vladimir SAITI, që me të vërtetë ja kishte arritur qëllimit dhe Ju suksesit. Ju lutem ruajeni dhe kultivojeni edhe më tepër koreografinë e stërlashtë të trevës shqiptare të Shestanit, Krajës, Ulqinit e të Tivarit, se ato janë pasuri brilante të shpirtit artist të këtyre krahinave epike shqiptare. Ju përgëzoj me gjithë zemër. Ndjehem i nderuar me prezencën time në mesin tuaj dhe aq më tepër të bëj një foto si kujtim me Ju – Ju faleminderit! Dhe grupi i Valltareve të Shestanit merr rrugëtimin drejtë Ulqini, për t'u rikthyer përsëri në skenën e Teatrit "Migjeni", me perla të reja edhe më të bukura, nga krahinat mitologjike të Shestanit, për të sjellë këtu aromën dhe madhështinë e folkut e të etnografisë së dikurshme të trevave iliro-dardane, përreth Majës Hyperike të Perëndive Pellazgjike të Rumisë.

* Teksti dhe fotot nga Prof. **Gëzim My. Uruçi** – euroetnolog, etnograf i shoqatës kulturore-artistike "Kënga e jonë", Shkodër, me 25 mars 2011.

**Nga fjala e mbajtur në takimin me studentët e fakultetit Histori-Gjeografi, Instituti i Lartë Pedagogjik. Shkodër më 27 nëntor 1982. Ruhet i plotë në Arkivin e Prof. G. Uruçit, Shkodër.



Në këmbë: Gjergj Rrok Pekaj, Pjetër Antoni-Marnikaj, Zefi Gjonit Lucit Nojs-Kovaçi (Pema), Artisti Besim Zekthi, Gjergj Pepgjoni, Nikë Luviqi-Pekaj, ulur: Lori Pals Leks-Lukiqi, Nikë Luviqi-Pekaj, Palë Anton Duraj, Valentin Zef Kovaçi, Nikollë Dukagjini

Shestanasit prej Krruçit, Krythës, Salçit, Kullomzës dhe Braticës për Kshnella, në kishën e Salçit, më 25.12.1934.

Kjo është një fotografi me vlerë të madhe historike. Shestaneshat të gjitha janë në veshje kombëtare shqiptare me gërshetin karakteristik për traditën e Shestanit; disa vajza (vasha) të reja e kanë bashbezën (bezën, shaminë) e bardhë të pështjellur nën mjekër, shenjë që janë pjekë (janë adoleshente). Disa Shestanas të rritur kanë çakshir të bardhë, ku qartë shihen shiritat e zi, në ç'mënyrë Shestanasit mbanin zi për Gjergj Kastriotin-Skenderbegun dhe për flijimet e asaj kohe. Veshja e bardhë ndër Shestanas mbizotëroi deri tash vonë; atë ia u lanë trashëgim Ilirët, të parët e tyre, të parët e të gjithë shqiptarëve.

E përgatiti Simë Gjon Dobreci



1.Gjoni Lek's (Lul's)-Dobreci, Braticë; 2.Marku'j Niks Kol'Niks-Dobreci, Braticë; 3.Kola'j Nrek's Simonit Junkaj (Junkoviq'), Krythë; 4.?.; 5.Kola'j Pal's Nik's-Jankaj, Salç; 6.Luka'j Macit Luk'Pâlit-Pecaj (Peciq), Salç; 7.Stjepa'j Hil's Martin-Lulaj (Luloviq), Kullomzë; 8.Leka'j Luk's Markut Pâlit-Junkaj (Junkoviq), Salç; 9.Sima'j Macit Preçit Niks-Dabaj (Daboviq), Krythë; 10.Preçi Kol's Preçit Kol'Simonit-Kolaj (Koloviq), Salç; 11.Pala'j Sim's Preçit Kol'Simonit-Kolaj (Koloviq), Salç; 12.Gjoka'j Stjep's Ilisë-Maroviq, Krythë; 13.?.; 14.Preçi Çob's Preçit Per'Gjok's-Dedaj (Dediq), Krythë; 15.Luka'j Pal's Nik's-Jankaj, Salç; 16.Gjergji Nik's Pjetrit Ujk's-Lukiq, Kullomzë; 17.?.; 18.Pjetri Enjllit Kol'Gjur's-Markaj (Markoviq), Kullomzë; 19.?.; 20.?.; 21.?.; 22.Kola'j Çek's Monit-Brisku (Briskoviq), Salç; 23.?.; 23.b.?.; 24.?.; 25.?.Preçi Luk's Markut Kol'Luk's-Dabaj (Daboviq), Krythë; 26.Zefi Pjetrit Vuk's-Dedaj (Dediq), Krythë; 27.?.; 28.?.; 29.?.; 30.?.; 31.?.; 32.?.; 33.?.; 34.?.Alekoja Nik's Lecit Kol'Simonit-Kolaj (Koloviq), Salç; 35.?.; 36.?.; 36.b.?.; 37.?.; 38.?.; 39.Prithti Dom Pala Marvulaj (Marvuliq)'; 40.Jâku'j Lek's Nil's-Nilaj (Niloviq), Kullomzë, ose Luci Pals Pjetrushit Maroviq, Krruç; 41.?.; 42.?.; 44.Palina (Lina) Niks Pjetër Pâlit Junkaj (Junkoviq), shtja³ Pjetrit Niks Markut Per'Gjoks-Dedaj (Dediq), Salç; 45.?.; 46.?.; 47.Marku'j Preçit Niks Marluk's-Bardhonj, Salç; 48.?.; 49.Dila, shtja Zefit Luks Markut Luks-Lukmarkaj-Lukiq, Salç; 50.?.; 51.?.; 52.?.; 53.?.; 54.?.; 55.?.; 56.?.; 57.Zefi Luks Markut Luks-Lukmarkaj-Lukiq, Salç; 57.?.; 58.?.; 59.?.; 60.?.; 61.?.; 62.?.; 63.?.; 64.Mara Pers Stjep'Rudit Marvuçiq, Zalef, Tivar, shtja Pjetrit Niks Nreks Vukmarkonj (Vukmarkoviq), Krythë; 65.Ângja, shtja Lek's Markut Preçit-Paluc-Lukiq, Salç; 66.?.; 67.Dila'e Lek's Gjonit Leks (Lul's)-Dobreci, shtja Rrokut Gjeks Macit Kol'Gjoks (Kolgjoklaj)-Marnikaj, Bishti Malit, Ulqin; 68.?.; 69.Dran'ja'e Lek's Gjonit

Leks (Lul's)-Dobreci, Braticë, shtja Sims Toms Per'Simonit-Dedaj, Krruç; 70.?, 70b. Mrika'e Kol's Preçit Kol'Simonit-Kolaj (Koloviq), shtja Preçit Stjep's Macit-Lukiq, Kullomzë; 71.?.; 72.Mrika'e Lek's Gjonit Leks (Lul's)-Dobreci, Braticë, shtja Jakut Kols Macit Kol'Gjoks (Kolgjoklaj)-Marnikaj, Bishti Malit, Ulqin; 73.Lena'e Pal's Gjonit-Nilaj (Niloviq), shtja Luk's Macit Çekut-Margjonaj (Margjonoviq), Kullomzë; 74.?.; 75.?.; 76.?.; 76.b.?.; 77.Prena'e Sim's Gjonit Mâronj-Simonaj (Simonoviq), Braticë; 78.?.; 79.Dila, shtja Nik's Pal's Gjergjit Pjetër Niks Marnikaj (Marnikoviq), Kodrat, Ulqin.

1.Administrata malazeze mbiemrave u ka shtue viq ose iq.

2.Dom Palë Marvulaj ka qenë i biri i Gjurës, fisi Gjokvuçaj, prej mhallës Stankaj, prej katundit Nrekaj Naltë (Karanikiqi), Shestani Poshtë. Në këtë katund, më 1881, është i shënuar *Nikë Marvula* (56 vjetësh), i cili ishte axha i dom Palës dhe vëlla i Gjurës (30 vjetësh). Don Pala ka shërbye në Tuz, Salç, Kllezën (më 1927 dhe në 1928) dhe Ulqin; vdiq në Tivar te nipi. Gjura'j Gjonit Gjurës. *Shih edhe* 'Dëshmi' BUZUKU 26/2008:11.

3.Shtja - shortja, bashkëshortja.

Fotografimi më 1934 ose 1935, për Kshnella, para kishës së Salçit (Ulqin).

Shënimet i dhanë: 1.Ângja'e Sim's Preçit Kol'Simonit-Kolaj (Koloviq), e lindur më 23.8.1915 në Salç (Ulqin), shtja Markut Gjonit Gjekë-Lula. I shënoi nipi Sandri Gjonit Markut Gjonit Gjekë-Lula, më 2.4.2010 në Ulqin. 2.Marku'j Niks Pjetrit Niks Markut Per'Gjoks-Dedaj (Dediq), më 15.10.2010, Krythë, Ulqin.

DËSHMI: Neve shqyptarve, më 1912, kur Kllezna ka ra nën Malin e Zi të Krajl Nikollës, mbiemnat (emnat familjarë) na i kanë shkruar me –ov, për shemull, Markov, Nocov. Edhe malazetët në atë kohë i kanë pasë mbiemnat me –ov (Jovov, Jokov, Savov). E pak ma vonë, në kohën e Jugosllavisë mretnore, na i kanë nrrue, në vend të –ov, na kanë vu –viq (Markiq, Koçoviq).

Tregoi Gjergji Noc Filipit (15 janar 1919-), Kllezën, Ulqin, më 19 fror 2011.

Pal Deshpali vazhdon aktivitetin

Pal Deshpali – muzikant i famshëm kroat prej Arbanasit të Zadrës me rranxë prej Shestanit

Shkruan Sylejman Morina

Aktivitetet e maestros Pal Deshpali, vazhdojnë bashkë me aktivitetet e filharmonisë së Zagrebit. Sivjet numrit të mirënjohjeve e shpërblimeve iu shtua edhe një, për vepër jetësore shpërblimi “Porin” në kategorinë e muzikës klasike dhe atë të xhazit. Manifestimi ishte mbajtur në Teatrin Popullor kroat të Shibenikut, më 8 maj 2010. Kjo është mirënjohja më prestigjioze diskografike në Repub-

shfletuar. Artikullin e tuaj do t’ia tregoj farefisit tim, por pasi ta bëjë përkthimin një mik shqiptar”.

Shkrimi në një gazetë në gjuhën shqipe, shihet qartë se si e ka përceptuar. Gjë që kjo është një dëshmi e mjaftueshme e përjetimit emocional të tij. Edhe sikur mos të shkruhej fare për të, autoriteti i tij nuk do të pësonte kurrfarë ndryshimesh. Mjerisht, është krijuar një traditë jo e mirë për njerëzit tanë, të gjakut tonë kudo që janë, nuk i përfillim dhe nuk ua shfrytëzojmë dijen, përvojën e autoritetin e tyre të krijuar në saje të aftësive dhe punës së tyre profesionale. Thënë shkurt, nuk dimë apo nuk duam t’i respektojmë vlerat tona, ndërsa ndaj të huajve, qofshin edhe me vlera më të ulëta se njerëzit tanë, i vlerësojmë së tepërmi. Njerëzit tanë vetëm kur nuk janë më, fillojmë të mësojmë për ta, për vlerat e tyre të njëmendta, edhe nganjëherë në nismë nga të huajt.

Shembulli më i freskët është kolosi ynë i filmit dhe teatrit me përmasa ndërkombëtare, Bekim Fehmiu. Për të është shkruar e folur pas vdekjes më tepër se sa gjatë të jetës. Vërtetë një promovim post mortum i artistit të madh me vlera ndërkombëtare! Me siguri e ka merituar të shkruhet për të shumë më herët, të informoheshin gjeneratat e reja me veprimtarinë e mirëfilltë artistike të këtij personaliteti. Ndërsa institucionet dhe mjetet kroate të informimit, treguan respekt të



Pal Deshpali me fëmijët e vet

veçantë ndaj personalitetit të akademik Pal Deshpalit. Sivjet Zara kishte një manifestim kulturor jubilar, pra u shënua 50 vjetori i festivalit muzikor “Netët muzikore në sheshin e Shën Donatit”. Ky është festivali muzikor ndër më të vjetrit në Kroaci, ku bashkëthemelues ishte maestro Pal Deshpali. Kësaj radhe ai ekzekutoi veprën e babait Shime, kompozimin “Moba” me filharmoninë e Zagrebit. Shime Deshpali e kishte kompozuar këtë enkas për manifestimin e parë të mbajtur para gjysme shekulli (1960). Atëherë Shime ishte me tre fëmijët, pjesë e programit Pali, Maja dhe Vallteri. Në këtë jubile që ishte nën patronatin e kryetarit të Kroacisë, Josipoviç, ndër pjesëmarrës kishte figura të shquara nga jeta politike, fetare, kulturore e Zhupanisë së Zarës e më gjerë.

Aktivitetet artistike të akademik Pal Deshpalit vazhdojnë, nuk ka muaj që nuk paraqitet në ndonjë aktivitet muzikor, dirigjent mysafir i ndonjë orkestre, festival, anëtarë jurie, përvjetor apo manifestime tjera.

Maestro Pal Deshpali



likën e Kroacisë, e cila është themeluar më 1993 dhe rregullisht ndahet për çdo vjet. Vitin e kaluar, i biri i Shime Deshpalit shkrimtarit dhe kompozitorit të njohur me origjinë arbëreshe, akademiku Pal Deshpali festoi 75 vjetorin e lindjes duke organizuar koncerte anë e mbanë Kroacisë, të cilat i përcollën të gjitha mediat kroate. Tek ne nuk e përmendi kush akademikun e nderuar me vlera ndërkombëtare, nuk organizoi diçka, qoftë edhe sado simbolike për nder të tij. Thuaja se, nuk kemi krijuar kurrfarë institucioni kulturor në Kosovë e Shqipëri, sikurse të ekzistonte një bllokadë e ashpër informative tek ne. Për dallim vetëm gazeta e diasporës “Tung”, që botohej në Zvicër, ia kishte kushtuar dy faqe jubileut të akademikut - nënkryetarit të Akademisë Kroate të Shkencave dhe Artit (HAZU). Për këtë akademiku kishte shprehur falënderim të veçantë duke thënë: “Falënderoj për artikullin në të cilin..... sidomos në mirësjelljen e tuaj, si ju ka rënë ndërmend, jo vetëm që të shkruani për mua, por edhe të më dërgoni „magazinën-revistën“ e kompletuar, të cilën me kënaqësi e kam



Shime Deshpali me Majën, Palin dhe Valterin

Mullinjët e Malësisë së Rozhajës

Shkruan Ali Daci

Fshatrat e Malësisë së Rozhajës janë të pasura me ujëra; rrjedhat e tyre kanë shërbyer për të shuar etjen e njerëzve dhe bagëtisë, për ujitjen e kopshteve, për të venë në lëvizje gurët e mullinjve dhe tehet e mprehta të sharrave, si dhe për të ushqyer vendasit me mishin e shijshëm të peshkut, troftës së dëgjuar. Këtu po trajtojmë çështjen e mullinjve të cilët gjatë shekujve kanë ekzistuar e që ekzistojnë edhe sot, por nga 16 sa kishte Malësia e Rozhajës dikur, sot punon vetëm një mulli, Mulliri i Ukë Ramë Lajçit në Husaj. Mullinjët në fshatin Buxhov, prej katër që punonin pa nda deri para një kohe jo të largët, sot kanë ngelë vetëm tre skeletet e tyre përgjatë rrjedhës së lumit Vrella e Malësorëve, si dhe Mulliri i Dreshajve në rrjedhën e Moraçës që është tërësisht i shkatërruar. Një i Buxhovas që e do shumë vendlindjen, Isa Rexhep Nikçi premton se në të ardhmen do të rindërtoj mullirin që ia ka lënë i ati.

Mullinjët e blojës përbënin një zeje të traditës, që kishte rol të dyfishtë në familjet shqiptare, atë fitimprurës dhe sigurimin e bukës së gojës. Në njërën anë mullisi bluante bukën e gojës për familjen e vet dhe në anën tjetër nga ujemi siguronte bukën rezervë për familje dhe bagëtinë e familjes patriarkale shqiptare. Këta mullinj përbënin “industrinë” ushqimore familjare që merreshin me blojën e drithërave dhe prodhimin e miellit. Që në kohë të lashta drithi këtu bluhej në mokra në mullinj, që shfrytëzonin energjinë e ujërave të rrjedhës së Vrellës së Malësorëve. Kështu fshatarët Buxhovas, përgjatë kësaj rrjedhe të pashtershme të këtij burimi të rrembyeshëm, kishin ngritur mullinj:

Mulliri i Rexhep Ahmet Nikçit, Mulliri i Shaban Rekë Nikçit (mulliri i Nikçit), Mulliri i Qerim Mehit (Mulliri i Lajçit), Mulliri i Rekë Alisë (Mulliri i Dreshajve), që kohën e fundit bloi në rrjedhën e lumit të Moraçës në krahun e djathtë të katundit malor. Malësori Buxhovas në arat e veta ka mbjellë gjatë shekujve drithërat e bardha siç ishin: elbi, hejda, tërshëra, thekra dhe meli. Familjet shqiptare patriarkale kishin nevojë të madhe për ngritjen e kësaj “industrinë” ushqimore, pasi që misri në këto kushte atmosferike tipike alpine nuk kultivohej, ku dimrat janë të gjatë dhe të vështirë, e që buka e kultivuar në arat malësore nuk përmbushte kërkesat e familjes, ata detyroheshin që, përmes Grykës së Rugovës, misrin ta sillnin në



mullinjët e vet, ose drithi sillej përmes Grykës së Zhlepit dhe përmes bjeshkës së Shtedimit. Të gjitha këto rrugë ishin me plot rreziqe, si nga faktori njeri ashtu edhe nga ai klimatik natyror.

Ndërtimi i mullinjve

Për ndërtimin e mullinjve malësorët përdornin materialin që e kishin në këto anë, pra drurin e mjaftueshëm. Teknika e ndërtimit të këtyre ndërtesave prej druri ka qenë ajo e lidhjes *gojë më gojë*; ndërtesa rrethohet në të katër anët me trungje, të cilat ndër qoshe janë inkasuar njeri më tjetrin në mënyrë që dy krrerët të dalin përjashta. Dyert e mullinjve kanë qenë të hapura kryesisht me pamje nga lindja, pasi që streha e bjeshkëve këtu me hijen e saj që në orët e para të pasdites mbulon rrjedhat e lumit. Lënda drusore këtu çahet me mjete primitive, më sëpatë dhe sharrë krahu, kurse më vonë me motosharrë. Në mungesë të sharrave ata ponicat e mureve i gdhendnin me sëpatë e më vonë ato u sharruan më anë të sharrave më *vek*, që ishin sharra krahu, ku për çarjen e një trupi nevojiteshin tre veta, dy sipër *vekut* për tërheqjen e sharës nga poshtë - lartë dhe një në anën e poshtme



tërhiqte sharrën nga lartë drejt tokës.

Pjesët që përbejnë një mull

Mullinjët e blojës përbeheshin prej pjesëve, që po i numërojmë nga aty ku fillon lëvizja e rrotës së mullirit nën shtypjen e fuqisë së ujit i cili sillet prej grazhdit drejt lugut të punuar nga druri i molikës: **pela** prej drurit e cila shërben për ngritjen dhe uljen e gurit të mullirit, shoqërohet me disa pyka ahu në krye, që quhen edhe pykat e kurdisjes, **përajat** e drurit të cilat e vënë në lëvizje rrotën e drurit e cila është e mbështjell me rrathë hekuri, **kërcela** ku mbështetet boshti i hekurit; në dyshtemenë e mullirit është e ngritur **veku** prej druri në të cilin janë të montuar guri i poshtëm dhe guri i sipërm i mullirit. Guri i poshtëm është statik, kurse guri i sipërm rrotullohet në drejtim të akrepave të orës dhe me lëvizjet e tija bluan kokrrat e drithit. Sipër gurëve qëndron **koshi** i drithit i cili mban zakonisht 50 kilogram drithë, në fund të saj është një vrimë e cila lëshon kokrrat e drithit në **lucicën** e drurit e cila i përcjellë ato me rënie të lirë nën gurë të mullirit. Në lucicë vendoset **çakallja** e cila me një gjuhëz prek gurin e sipërm i cili me rrotullimet e tija po ashtu dikton rënie e kokrrave të drithit drejt në mokër. Mielli i cili del paksa i ngrohtë nga guri derdhet në **muzhik** të ndërtuar nga dërrasat e lëmuara mire. Aty është edhe **lopata** e ndërtuar nga druri e cila shërben për mbartjen e miellit nga muzhiku në thes. Po ashtu në mullin përdoret edhe **shosha** për shoshitjen e drithit dhe njëkohësisht ka shërbyer për matjen e **ujemit** i cili është sjellë nga 5 përqindëshi i blojës së përgjithshme. Gurët e këtyre mullinjve janë sjellë me kuaj nga Mitrovica, kuptohet të ngarkuar në samar mbasi që rrugë për qerre në atë kohë nuk kishte.

Pranuar më 7 for 2011



Ruani ullinjtë alarmojnë të rinjtë

Shoqata “Creative City” organizoi koloninë e artistëve të rinj dhe ekspozitën e punimeve me motive të ullirit

Shoqata “Creative City” hapi të shtunën më 29 janar 2011, në Galerinë “Art” të Qendrës së Kulturës në Ulqin ekspozitën me punime të fëmijëve të shkollave fillore të Ulqinit që për motiv kanë ullirin. Artistët e rinj talentin vet krijues e kanë paraqitur me punime të realizuar në teknika të ndryshme, si pikturë, vizatim, kolazh, skulpturë.

Piktori Jozo Koçoviq, anëtar i jurisë për vlerësimin e punimeve, tha se “numri i punimeve të mira është shumë i madh, ato janë punuar me kreativitet dhe se nuk ka qenë lehtë të bëhet përzgjedhja e tyre”.

Kolonia e artistëve të rinj dhe ekspozita me punimet artistike është zhvilluar në kuadër të projektit “Ulliri – floriri i Ulqinit”, i cili realizohet nga “Creative City” me mbështetjen e Programit Kulturor Zviceran në Ballkanin



Perëndimor. Koordinatorja e këtij projekti, Leze Llazari, tha se qëllimi i organizimit të kolonisë artistike është vetëdijesimi i brezit të ri që të trashëgojnë dashurinë për pemën e shenjtë, ullirin.

Juria e përbërë nga piktorët Vahida Hasanaga Nimanbegu, Jozo Koçoviqi, Bilal Nikeziqi dhe Edin Kapllani shpall punimet më të mira të nxënësve Julija Kallugjeroviq, Dhurata Kuqi, Aleksandra Klikovac, Danijela Dragojeviq, Nina Gjakonoviq, Anton Shkreli, Jelena Gazivoda dhe Genta Shurdha. Për kolazhin më të mirë u shpërblye punimi i Angjela Gazivodës, vizatimin - Elodi Jakupit, vizatimi me kolor - Natasha Gjurishiq, ndërsa për skulpturë - Jakup Jakupi. **Shkruan Ismet Kallaba**



Burrnohemi me Nënë Tereze

Një popull që ka dhanë Nënë Tereze nuk mund të jetë popull i vogël.

Na shqiptarët ia dhamë Botës këtë NËNË

Në Ulqin, sot, më 10 dhjetor 2010, përkujtojmë 31 vjetorin, ditën, kur më 10 dhjetor 1979, Nëna Tereze mori në Oslo çmimit



Nobel nga presidenti i Komitetit Nobel për Paqe, Dr John Sannes, i cili, në aeroportin e Oslos, gjatë përcjelljes së Nënë Tereze për kthim në Kalkutë, ndër të tjera theksoi: “Këtu me të vërtetë nuk dimë se kush ka marrë dhuratë: ne apo Nëna Tereze. Lars Roar Langslet, Kryetari Komisionit Parlamentar për marrëdhënie me Kishën dhe Arsimin, mes tjerash dëshmoi: “Tërë bota e miratoi, kësaj here, vendimin e Institutit Nobel, që Dhurata e madhe e Nobelit për Paqe t’i jepet bamirëses së njerëzimit...në shenjë mirënjohje për dashurinë e bamirësinë bërë njerëzimit mbarë pa dallim. Në Nënë Tereze populli shqiptar mund të gjejë vetveten e shpirtin e vërtetë, bashkimin shpirtëror e kulturor, arsyen themelore për bamirësi, për paqe e pajtim, për bashkëpunim e bashkëjetesë me të gjithë, pa dallim e pa përjashtim, duke mësuar e ushtruar artin e jetës, të dashurisë e



të vëllazërimit. Nëna Tereze e pranoi këtë Shpërbllim vetëm në emër të të varfërve, për t’i ndihmuar të varfrit ndër më të varfër, duke vërë në qendër të vëmendjes dy shtylla, shpesh të harruara dhe të ngatërruara, ZOTIN dhe NJERIUN.


Ky takim u realizua në bashkëpunim në mes të shoqatave në qytetin tonë, FORUMI RINOR “BUZUKU” dhe “QYTETI KRIJUES”. Leze Llazari i përgatiti thëniet njerëzore të mrekullueshme të Nënë Tereze, të cilat në mënyrë të shkëlqyeshme i recituan Domenik Lukiqi dhe Albina Antoni. Në Shtëpinë e Kulturës, u shfaq filmi dokumentar për jetën e veprën e NËNËS TEREZE dhe në natën e dytë filmi dokumentar mbi veprimtarinë e NËNES SE BOTËS, prodhim i BBS.Tubimin e zbuluar të rejtat e të rinjtë me veshje kombëtare të komunës së Ulqinit. *G.G. Buzuku Press*, më 10 dhjetor 2010.

ART CLUB - njëzet vjet kulturë



Shoqata e Artistëve dhe Intelektualëve "Art Club" nga Ulqini shënoi njëzet-vjetorin e themelimit të saj me një veprimtari kulturore, që u zhvillua më 27-28.XII.2010 në Bibliotekën e Qytetit, Ulqin, në kuadër të manifestimit "Kultura e shqiptarëve në Malin e Zi".

Natën e parë të veprimtarisë kulturore u përruan librat e botuara nga "Art Clubi": mr. Haxhi Shabani "Jam ai që nuk jam", mr. Anton Gojçaj "Ndërmjet kapakëve" dhe dr. Nail Draga "Kultura dhe shoqëria civile".




Në mungesë të kritikut Ndue Ukaj, u lexua një pjesë nga recensionin kushtuar librit të Haxhi Shabanit, marrë nga libri, si dhe pjesë nga vlerësimi i poetit Xhevahir Spahiu: "Lirika e Haxhi

Shabanit është e përshkuar fuqishëm nga motivet e dashurisë, mirëpo, ato tejkalojnë dimensionet e prekshe të retorikës monotone dhe kështu bëhen shënues të përjetësive universale. Sikur një kopsht bregdetar, me fruta të gjithfarshme, është poezia e Shabanit, e pasur, me figura të bukura poetike, me ndjesi të stërhollë, të përshkuara nga emocione të fuqishme", thuhet ndër të tjera në recension.

Për librin "Ndërmjet kapakëve" të Anton Gojçajt foli studiuesi Gjovalin Çuni, drejtor i Bibliotekës "Marin Barleti" në Shkodër. Ai tha se "rrëfimet

e Gojçajt janë rrëmime në shpirtin e shqiptarit, janë shpërthime akumuluese, shkarkim energjish, janë ritmet e një universi befje, të një kohe që ka kaluar, por është përsëri e pranishme. Gojçaj është prurje në letërsinë shqiptare të Malit të Zi dhe pjesë e atij grupi letrarësh të rinj, tanimë elitë e letrave shqipe.



Përkthyesi dhe kritiku Qazim Muja për librin e dr. Nail Dragës "Kultura dhe shoqëria civile" tha se Draga shqetësohet për mungesën e kujdesit ndaj trashëgimisë kulturore të shqiptarëve dhe komunikimin e munguar kulturor ndërshtetërisht, në veçanti të atij institucional. Libri duhet kuptuar si apel për ndryshime të njëmendta duke filluar nga politika kulturore, gjuhësore, arsimore e deri tek politikat e të drejtave të njeriut, sidomos të shqiptarëve në Mal të Zi si kategori tërësisht e veçantë kulturore e gjuhësore.

Pas vlerësimeve të recensuesve, folën edhe autorët e librave.

Natën e dytë u bë përrurimi i botimit jubilar "20 vjet kulturë" si dhe u shfaq filmi dokumentar "Rikthim në iden-

titet" kushtuar veprimtarisë së "Art Club"-it. Botimi jubilar përbën një historik të kësaj shoqate ku janë përfshirë ngjarje si themelimi para 20 vjetëve, veprimtaritë e para, veprimtaritë botuese, përfshirë librat (rreth 60) dhe revistat, pastaj veprimtaritë tradicionale si "Kalimera poetike", përrurimet e librave dhe autorëve, sesionet shkencore, fituesit e çmimeve të "Art Club"-it, veprimtari në artet pamore, tryeza të rrumbullakëta, skena alternative e "Art Club"-it, përvjetorët, bashkëpunimi, donatorët e "Art Club"-it, mediet për veprimtaritë e "Art Club"-it.

Ndërkaq filmi dokumentar, i realizuar nga autori Haxhi Shabani, prodhim i Televizionit të Malit të Zi, është një sintezë apo përmbledhje e veprimtarisë së "Art Club"-it.

Për veprimtarinë e SHAI "Art Club", gjatë natës së dytë të shënimit të 20-vjetorit, folën të gjithë kryetarët e deritashëm e kësaj shoqate, shkrytari dhe publicisti Ibrahim Berjashi, Dr. Nail Draga, piktori Qazim Muja dhe mr. Haxhi Shabani.

*Marrë prej artikullit më të gjerë: Ismet Kallaba, Njëzet vjet kulturë, KOHA JAVORE 451/30.12.2010:19.

Korrekturë

Në BUZUKUN 33/2010, faqe 14, në: **Një fotografi më 1938**, në numrin 16, skruan vajza, duhet **Prena**; në numrin 25, në vend vajza, duhet **Mrika**; në numrin 32 shkruan shtja Preçit Macit-Karanikaj (Karanikiq), kurse duhet **Dila**, shtja Zefit Luks Markut Luks-Lukiq.

Djali me kashketë pa numër, poshtë majtas, është Gjergji Pals Kols Påliti-Pecaj (Peciç).

* Në BUZUKUN 34/2010, në faqe 11, reshti 9 prej fundit djathtas, gabimisht numërohen ndër këngëtarë edhe Zef Kovaçi dhe Gjergj Pëgjoni.

Në faqe 12, shkruan te numri 11. Pala'j Jozit Luks-Jankonj (Jankoviç), kurse duhet Pala'j Jozit Luks-Jankaj (Jankoviç).

Prej lexuesve kërkohet falje.

Shqiptari themeloi shtetin e Egjiptit

Mehmet Ali Pasha konsiderohet si themelues i Egjiptit modern, për arsye



MEHMET ALI PASHË EGJIPTI
Më 1840 pikuroi Louis-Charles-Auguste Courder (1790–1873) Paris (Bibliotheca Alexandrina)

të reformave të rëndësishme në ushtri, ekonomi dhe kulturë. Ai sundoi Egjiptin (17 maj 1805 – 2 Mars 1848), Sudanin, Palestinën, Sirinë, Hixhazën, Morenë, Thasosin dhe Kretën. Ishte shqiptar, sundimtar që u vetëquajt mbret i Egjiptit dhe Sudanit. Ai po ashtu sundoi territorin e Levantit jashtë Egjiptit. Dinastia që ai e themeloi, do ta sundoi Egjiptin dhe Sudanin 150 vjet, edhe 3 vjet mbas revolucionit egjiptian 1952. Mehmet Ali Pasha jetoi 80 vjet (4.3.1769 - 2.8.1849)

Biografia

Mehmet Alia lindi në Kavallë, Maqedonia otomane (sot nën Greqi), në një familje shqiptare. Si mbas shumë njerëzve që e takuan, e vetmja gjuhë që ai e ka folur mirë, ishte shqipja, kurse pak më dobët turqishtja. Ishte i mençur dhe largpamës. I ati i tij, Ibrahim Aga ishte tregtar me duhan, kurse e ama e tij, Zainaba ishte e bija e Husein Agës, zyrtarit otoman të Kavallës. Mbasi i vdes i ati sa ishte Mehmeti ende i vogël, u kujdes për te daja i tij, Husein Aga. Daja ia mundësoi titullin *bulukbashë* dhe privilegjin e mbledhjes së tatimit në Kavallë dhe rrethinë. Për arsye të shërbimit të mirë, e përparuan në komandant të shkallës së dytë të kushëritit vet Sareçesme Halil agës, dhe e dërguan me Njësitin Vullnetar prej Kavallës në Egjipt më 1801, i cili

mbeti në anarki mbas tërheqjes së Napoleonit. U martua me vajzën e Ali Agës, Emine Nosratlinë, vejushën e pasur e Ali beg Al-Kabirit.

Kur Mehmet Alia mbërriti në Egjiptin otoman, aty kanë luftua për epërsi Turqit dhe çifligaret vendas (Mamluket, fuqia e të cilëve ishte dobësua mjaft në kohën e Napoleonit). Në atë kohë anarkike, Mehmet Alia me ndihmën e shqiptarëve të tij vullnetarë besnikë, luajti në të dyja anët, por me kujdes që ai të ketë dobi. Ndërkohë, udhëheqësit fetarë lokalë të Egjiptit kërkuan vetë që të ndërrohet sunduesi i deriatëhershëm, Ahmed Kurshid Pasha, e në vend të tij të caktohet Mehmet Alia, ashtu që Sulltani, më 1805 e shpalli guvernator dhe pashë të Egjiptit.

Në fillim, Mehmet Alia sundonte me kujdes, përpique të forcojë pushtetin e vet; donte me kohë t'i ç'fuqizojë çifligaret vendas (Mamlukët), të cilët e kishin sunduar Egjiptin mbi 600 vjet dhe kishin ende ndikim në pushtet. Për këtë arsye, Alia vendosi ta zhduk parinë e tyre; i thirri në festim në Kajro më 1811 në darke në kështjellën e tij, me rastin e përcjelljes të birit Tusunit për ekspeditë në Arabi. Kështjellën e rrethoi me roje Shqiptare, të cilët i urdhëroi të ekzekutonin parinë mamluke. Si mbas disave, ishin 74 të vrarë, si mbas tjerëve bile 500 udhëheqës mamlukë. Mbasi ia u vrau parinë, nisi ushtarët nëpër krejt Egjiptin që t'i zhdukin të gjitha fuqitë e mbetura

të mamlukëve. Mehmet Alia e shndërroi Egjiptin në fuqi regjionale, dhe sillej si vazhdues natyror i Mbretërisë Otomane, shtetas i varur i të cilës ishte formalisht ende, por në të vërtetë zbatonte politikën e vet.

Reforma e qeverisjes së Egjiptit

Mehmet Alia dëshironte të modernizonte Egjiptin si mbas shembullit të shteteve evropiane; këtë donte të zbatojë edhe sulltani otoman Selimi III, por për arsye të kundërshtimit të madh të ushtrisë së vet dhe të parisë fetare, në fund e spostuan dhe e vranë. Alia nuk deshë t'i përsëris gabimet e tija. Detyra e parë ishte të sigurohen të ardhurat e pandërprera shtetërore. Që ta mbërrijë këtë qëllim, Mehmet Alia *nacionalizoi* krejt tokën në Egjipt. Kësaj ia arriti me rritjen e madhe të tatimit, dhe mbasi shumica nuk kishin mundësi ta paguajnë, ai u konfiskonte tokën. Praktikisht, kjo ishte monopolizim shtetëror të krejt tokës dhe tregtisë të Egjiptit. Mbas rregullimit të çështjes së bujqësisë dhe të financave, ai kaloi në krijimin dhe pajisjen e ushtrisë moderne. në Kairo organizoi manufakturën prodhuese të armatimit, topave. Organizoi anije-ndërtuesën në Aleksandri, kah fundi 1830 Egjipti prodhoi 9 anije me nga 100 topa; prodhonte nga 1.600 pushkë në muaj. Alia po ashtu themeloi fabrikat e para të tekstilit në Egjipt.

Por më të shumtën interesohej për krijimin e qeverisjes moderne dhe të ushtrisë profesionale. Për këtë arsye dërgon shumë të rinj për studime në



Auduiencia te Mehmet Ali Pasha (Pallati në Aleksandri, 1839)
Pikuroi (vaj) David Roberts (24.10.1796 – 25.11.1864, skotlandez)

Evropë. Sjell edhe shumë ekspertë evropianë të nevojshëm për ndërtim të shkollave dhe spitaleve, si dhe për stërvitjen e ushtrisë. E reformoi qeverisjen në Egjipt, e ndau në 10 provinca, për guvernator caktoi djemtë e vet, që i përgjigjshin vetëm atij. Ai më 1835 themeloi shtypshkronjën moderne, të parën në botën arabe, e cila shtypte gazetë zyrtare të qeverisë së tij.

Ekspeditat ushtarake

E para ekspeditë ishte në Gadishullin Arabik – ku kishte kundërshtua qeverisjen otomane fisi Saud (dinastia e ardhshme Saud). Këtë detyrë ia besoi sulltani Mahmud II, sepse Sauditët kishin zaptua qytetet e shenjta myslimane. Djemtë e Mehmet Alisë, Tosumi dhe Ibrahim Pasha arritën që t'i shtypin Saudët dhe të kthejnë qytetet e shenjta, Mekën e Medinën në gjendje paqeje. Mbas ekspeditës, që zgjati dy vjet, shumica e anëtarëve të fisit Saud janë burgosë, si dhe udhëheqësi i tyre Abdulah ibn Saud, të cilin e dërguan në Stamboll, ku e mbyten.

Ekspedita dytë, që ishte krejt e pavarur prej Portës së Lartë, që e ndërmoi Mehmet Alia, më 1820-1822 ka qenë në Sudan, ku në 1823 themeloi shtetin e Sudanit dhe Kartumin si kryeqytet. Atje dërgoi 5000 ushtarë, të cilët është dashtë të zgjerojnë pushtetin e tij sa më në jug, deri në Ugandë e Etiopi; këtë ekspeditë e udhëhoqi djali i tretë i tij, Ismaili. Ekspedita kundër fiseve dobët të armatosura pati sukses. Alia e vendosi qeverisjen e vet në Sudan, e cila mbeti në kujtesë për vrazhdësinë e madhe ndaj banorëve lokalë.

Ekspedita e tretë e Alisë ishte në Evropë, në More (Peloponez), ku plasi kryengritja kundër pushtetit otoman (lufta greke për pavarësi), të cilën sulltan Mahmudi II nuk ia doli ta shtypte. Për këtë arsye e caktoi Mehmet Alinë për sundues të Moresë dhe Kandisë (Kretës) më 1824. Në këtë ekspeditë Alia dërgoi djalin e vet me përvojë, Ibrahim Pashën. Ai u nis për More më 4 qershor 1824, me 17.000 luftëtarë, kurse mbërriti mbas disa muaj lundrimi dhe me shumë vështirësi më 26 fror 1825. Ibrahim qëndroi në More tre vjet, deri që kapitulloi më 1 tetor 1828, çka e detyroi intervenimi i fuqive evropiane (Britania e Madhe, Franca, Rusia).

Si kompensim për atë humbje, Alia kërkoi Sirinë prej Portës, por ajo u

shtirë e shurdhtë, për ç'arsye Alia më 31.10.1831 dërgoi djalin Ibrahim Pashën që me force ta marrë Sirinë. Ai pat sukses, e mori edhe Damaskun (27 maj 1832). Pastaj sulmoi Azinë e vogël dhe detyroi vezirin e madh Reshid Mehmet Pashën të tërhiqet (21 dhjetor 1832).

Mahmud II dhe Portës iu duk që u fuqizuan mjaft dhe dërguan ushtrinë e vet në Siri më 1838, që ta kthejnë nën pushtetin e vet. Mirëpo, më 24 qershor 1839, ata e humben luftën gjatë ndeshjes me forcat e Ibrahimit. Por aty u përziën Britania e Madhe dhe Mretëria e Austrisë, intervenuan që të

ruhet integriteti i Mbretërisë Otomane. Anijet e tyre bllokuan deltën e Nilit dhe Ibrahimit ia bënë të pamundshme komunikimin me Egjiptin, kurse kryengritja nëpër krejt Arabinë e izoloi në Siri, ashtu që ai më në fund u detyrua ta lëshoi Sirinë në fror 1841. Para kësaj, fuqitë evropiane kërkuan prej Mehmet Alisë të heq dorë prej Kretës, të zvogëlojë flotën dhe të kufizojë numrin e ushtarëve në 18.000, por iu premtua që ai dhe mbasardhësit e tij edhe në të ardhmen mundën si mbretër të qeverisin Egjiptin dhe Sudanin.

Marrë në Wikipedia Pëgatiti Simë Gjon Dobreci



Marinarët e Ulqinit në jahtin e mbasardhësit të Mehmet Ali Pashë Egjiptit

Mbreti Faruk*, mbasardhës i Mehmet Ali Pashë Egjiptit, hyri në fron të Egjiptit me pëlqimin e axhës së vet, princit Hilmi Abazit. Princi kishte miqësi me Haxhi Shaban Pashën e Shkupit, me të cilin ishte mik edhe Cafo Beg Ulqini. Gjatë takimit me princin, Cafo Begu e njofton atë se Ulqini ka detarë të mirë me traditë shekullore. Princi Hilmi Abazi kërkoi marinarë për jahtin e tij NIMETALLAH.

Gjatë 4 vjetëve (1936-1939), në jaht punuan 18 vetë prej Ulqinit: Can Lazoja, Muhamet Pulti (gjellëbërës), Ismajl Malo Hoxha (motorist), Shaban Mavriqi, Nusret Shurdha, Mustafa Karaminxhoja, Dolfo Tërceta (kapiten prej Ulqinit me akademi të kryer në Kotorr), si dhe Emin Beci, Jonuz Dema, Halil Guçi, Cufo (Jusuf) Vogliqi, Rashid Hasanaga, Ganush Ishmi (Tulishmi), Riza Fici, Sulo (Sylejman) Fani, Hysni Resulbegu, Riza Çausi dhe Muhamet Arapi. Në jaht punonin gjithsej 35 anëtarë të ekuipazhit. Marinarët paguheshin nga 7 funta sterlina në muaj. Jahti ishte 2500 tonelatash. Mund të zhvillonte një shpejtësi prej 20 miljesh në orë. Princi Hilmi Abazi verës shëtiste në Mesdhe... Më së shpeshti qëndronte (gati krejt dimrit) në Monte Karlo, Kan dhe Nicë. Gjatë kësaj kohe, marinarët vinin për pushim në Ulqin.

Princi Hilmi Abazi, kah mesi i vitit 1939, me jahtin e tij erdhi në Tivar, ku e priti Cafo Begu me të vëllanë Hodon me të birin Kabilin. Pastaj bashkë erdhën në Ulqin. Princi i fali Cafo Begut dhe të vëllait Hodos ka një orë xhepi të gravuara me vulën e mbretit Faruk, ndërsa zonjës Meleqe – orën krejt prej arit, e cila gjindet tash te mbesa e Cafit, Xheraldina Buçinca-Vula në Prishtinë.

Për më shumë shih Fahri Buçinca, Cafo Beg Ulqini, Art Club, Ulqin 2009:74.

*Mbreti Faruk qëndroi në pushtet prej 28 prill 1936 - 26 korrik 1952, vdiq në eksil në [Itali](#) më 18 mars 1965.

Albana Lifschin
SHKALLA E POEZISË
A. Podrimjes

Zotëri, bujarisht
Që nga ai fron perëndie
Ku qëndroni Ju
Më lëshuat një shkallë...
Ngjitu! Më thatë

Po a mundem?
Tek ju shoh ju aq lart
Ndjej të më merren mend

6 tetor 2009, New York
Marrë prej KOHA DITORE, 26 dhjetor 2009:36
Zgjidhi Prof. Dr Mentor Disha, Prishtinë

Shaban Hasangjekaj
MOZAIK KOHËRASH

N'ujëvarë shndërrohesh
dhe melodi shekujsh
në vrapim pas rrjedhës.

Të ndjek errësira mes muresh
ti shpërthen në bardhësi
– ecën me kohën.

Kaluar ka nëpër furtunë motesh,
tani ecën me hapa ngadhënjimi
– shoqja ime e jetës.

*

PA TITULL

Mbjellë e kam dashurinë
në krahët e shpendëve,
në damarët e duarve,
në shkrepimat e syve,
në gulfimin e qeshjeve,
në thurjen e shikimeve,
në flokët e shpupuritura,
në buzëqeshjet e mëngjesit,
në shpirtin tënd o e pa emër.

S'kërkoj më tepër prej teje,
vetëm të bëhesh sorkadhe,
- rrëmbim i ëndrrave të mia.
Shaban Hasangjekaj, Martinaj, Guci

Xhemil Bytyçi*
NDERONI GJAKUN

Për Atdhe
Lot të derdhësh
Është mëkat
Të derdhësh gjakun
Është meritë e fat
Nderoni gjakun e derdhur
Për Atdhe...

*Marrë prej Xhemil Bytyçi, RREZE YJESH,
'Piramida' Prishtinë, 2010:91

MOS HARRONI

E keni lanë,
E tash po e kërkoni,
Ajo lotoi për ju,
E ju, po ia kaloni,
Sepse ju e dini,
Që ajo ju pret, po ju thret,
O, bijtë e mi, ju lutem,
Mos harroni kush jeni
E nga kah vini,
Edhe fëmijve tuej,
Në zemër tua thadroni,
Atë dashuni që juve u rriti!
E kurë e latë e shkuat,
Ajo nuk klithi e as nuk bërtiti,
Por nga zemra, në vend të lotit,
Dy pika gjaku, i qiti,
Sepse syni nuk pati ma lot,
E zemra u tha syve
Kurseni ato lot, se kam frigë,
Se do të lotoni për shumë mote,
Sepse i randë asht gurbeti,
Edhe pse zemra të digjet,
Ai nuk mëshirohet, nuk liget,
Nuk të lëshon nga kthetrat për shumë
mote,
Ai nuk i përfillë lotët,
Që për ty derdhë nana e jote!
Nuk u larguat me dëshirë,
Por hallet u detyruan t'i thoni,
Nanës, lamtumirë!
Na po shkojmë me kërkue,
Nji jetë ma të mirë,
Nji jetë ma të lirë.
Eh, moj nanë e dashtun,
Kur mendoj se përse jam largua,
Më dridhet trupi e shpirti nuk ka
rahati.
A e din moj nanë se zemra e shpirti,
Në çdo moment janë pranë teje, me ty,
E ky trup, i pa vlerë, dridhet,
Ashtu si dridhet thupra në ujë,
Plogështohet e shkrihet e zemra i thotë,
Ke lanë nanën, ke lanë vendlindjen,
Ke humbë kujtimet e ma të bukurës
stinë,
Ke harrue shokët, ke humbë rininë,
Këtu je nji vegël,
E atje ku linde, atje je mbret,
Atje lumtunia nuk ka fund,
Mërzia largohet e gëzimi të përfaqon,
Të njohin edhe gurët e malit,
Kur me kambë i rrokullisë,
Të rrethojnë kujtimet e fëminisë,
Për ty kangën e këndon lahutari,
Për ty, meshën e thotë famullitari,
E i lutet Hyut, me të ruejt,
E me ta pri për s'mbari,
E kumbonat rrahin,
Tingull gëzimi qesin,
Ndalohen njerëzia ,

Me kureshtje dvesin,
Ç'asht ky gëzim,
A din kush me na e thanë?
Na ka ardhë djali,
E na asht gëzua shpirti,
E lumja nana që këtë ditë e priti!
Janë gëzua burrat, gratë,
Pleqtë dhe fëmija,
Gëzimi s'ka fund se prapë,
Në këtë vend ka lind dielli,
Ka ardhë biri i nanës,
Nanën më e gëzua
Sepse të dyve shpirti u asht përvëlua,
E nuk mujt ma me durua i shkreti,
Ra, në prehën të nanës,
Iku nga gurbeti.
E nana e mori në prehën,
Sikur të ishte fëmi,
Ia përkdheli kokën, e puthi në ballë,
E mori për dore, tue hecë ngadalë,
Pa nji vashë të bukur,
Kush asht kjo,tha loke?
Përqafoje, birë,
Kjo asht motra e jote,
E motër e vëlla kur u përfaquan,
Zogjtë e malit kangën e ndaluen,
Nana i shiqonte e po derdhte lot,
Faleminderit Ty, o i madhi Zot!

Gjokë Dedë Shkreli,

Amull,qershor 1986.



Ilirët ia vunë themelet Kalasë së Ulqinit

Poezi për fëmi
Grejzat dhe Bleta

Grejzat janë bashkue
Bletët i kanë sulmue,
Ç'rregull keni naltë
Pse s'na jepni mjaltë?

Bletët u thanë punoni
Mandej ambësonuni.
Puna s'asht për ne
Grejzat thanë për ng !

Pasi s'doni me punue
U thanë tue fluturue,
Udhëtimin vazhdoni
Por, mjaltë s'do kërkoni.

**Gjon Berishaj, Tuz
mësues në pension**

Larg ma livdojshin nji vashë

Larg ma livdojshin nji vashë
 Larg e larg o anej detit
 Ma livdojshin besë se xuna
 Vashë e pashë e deri rash
 Ma mirë ish se ma livdojshin
 Por se ish o pak e vogël
 Për të vogel s'po kam dert
 M'so maj nanë o si ta marr
 Unë të soj o djali jem
 Unë të soj po me ndigjue
 Blej nji parë kazan t'ri
 Mushe plet me reshperi
 Shtin munash e bagasi
 Merr tridhetë o djelm të ri
 E tri parë o lodraxhi
 Bjeri detit del anej
 Kur t'afroresh në gjytet
 Nepju zjermin topavet
 Shtini djelm o të këndojnë
 Edhe lodrat të lodrojnë
 Atje kanë o nji adet
 Dalin vashat e shikojnë
 Ma e para vashë qi t'dalë
 Aja me kaftan të bardhë
 Mas menda se vasha jote
 Aja djalë isht vjehrra jote
 Ma e dyta vashë qi t'dalë
 Aja me kaftan jeshil
 Mas mendo se vasha jote
 Aja isht kunata jote
 Ma e terta vashë qi t'dalë
 Aja me kaftan me arë
 Aja isht djalë vasha jote
 Hajde vashë e zgjid mundash
 S'kam nevoj unë për mundash
 Se e kam babën kazash
 N'daç mundash, n'daç bagasi
 S'kam nevojë për bagasi
 Se e kam babën dugajxhi
 Vasha tuj u ulun-o
 Barka tuj përkundun- o
 Vasha tue zgjedh mundash
 Barka hidhej pash me pash
 Djali zemrën mushun plat
 Vasha sytë o deng me lat
 Ç'ke moj vashë o qi po kjanë
 Kam nevojë me kjamun-o
 Po la nanën vetem-o
 Po la nanë e po la babë
 Po la motër e vëlla
 Po la gjak e ilaka
 Po la shokë e po la shoqe
 Kqyr e banu vetë e mirë
 Se gjenë nanën ma të mirë
 Se gjenë nanë e se gjenë babë
 Se gjenë motër e vëlla
 Se gjenë gjak e ilaka
 Se gjenë shokë e se gjenë shoqe
 Sa i bukur gjethi ullinit
 Thon'ja kangës qi e dini
 Thon'ja ju se mirë e kini.

Shenoi: **Halil Kovaçi**, prej Arbneshit, Krajë, ekonomist i diplomuar, nëpunës në komunën e Tivarit. Këngën e shënoi kur ishte nxënësi VIII klasë, para më shumë se 30 vjetëve. *Shih edhe vizionet*: BUZUKU 13/2003:23, BUZUKU 31/2009:21, si dhe BUZUKU 34/2010:6 (që e komentoi Gjokë Dabaj).

Mrika Lenë shoqëja jonë

Mrika Lenë shoqëja jonë,
 A vjen shoqe shkojmë për lule?
 -Besa shoqe fort po due,
 Fort po due, keq po drue,
 Gjithsi keq po dru' moj shoqe
 Frigë po kam e Dardha* Melin.
 -Hajde shoqe, frigë mos ki-ë,
 Dardha Meli në ushtri-ë,
 Sot ka ardhë haberi zi-ë,
 Nesër vjen-ë kali shkretë-ë.
 -Prit moj shoqe, se po vinj-ë,
 Po vishem, po mathem-oë,
 Po vishinj dallâmën-oë,
 Po mathinj pashmâgan-oë.
 U nisën rrugës me shkue
 Shkuen në të parin mal-ë,
 Lule lypen, nuk u dhanë-ë.
 Shkuen në të dytin mal-ë,
 Lypen lule, pak u dhanë-ë.
 Shkuen në të tretin mal-ë,
 Lypen lule, mjathtë u dhanë-ë,
 Mlodhen lule, tri tube lule
 E u kthyen kah shtëpia.
 Po shkojnë rrug's ta bjesedue:
 -Po me kjenë-ë Dardha Meli,
 Çka kishe me bâ, moj shoqe?
 -Me m'u nodhë-ë thika ng'jat-ë,
 Veteveten e therinjesh,
 Dardha Melin s'e mirrnjesh-ë.
 -Po me kjenë-ë Dardha Meli,
 Çka kishe me bâ, moj shoqe?
 -Me m'u nodhë-ë zjarmi ng'jat-ë,
 N'zjarm binjesh e digjenjesh-ë,
 Dardha Melin s'e mirrnjesh-ë.
 -Po me kjenë-ë Dardha Meli,
 Çka kishe me bâ, moj shoqe?
 -Me m'u nodhë-ë uji ng'jat-ë,
 N'ujë binjesh e mytenjesh-ë,
 Dardha Melin s'e mirrnjesh-ë.
 -Dardha Meli jam e kjosha,
 Mrika Lenën e gëzosh.
 Briti Lena, ciku Lena,
 Zot ku virri, Zot ku briti,
 Gurë e dru-ë na'j çuditi.
 N'jev e âma të shtëpia:
 -Mos i ra-ë gjarpënia,
 Zot ma sillë-ë kah shtëpia.
 Nji e muer Dardha Meli,
 E gëzothtë si e ka-ë,
 T'vinj t'marre pajë e gjâ-ë.
 -S'due pajë-ë, s'due gjâ,
 Vashën desha, vashën mora,
 Dola në bedem kënova.

*Shestanasit në vend *dh* përdorin *ll*. *Tregoi Angja* (23.8.1915-), e ama e Gjonit Markut Gjonit Gjek'Lula, Kuçe, Totosh, Ulqin, me rranxë prej Briskut (pjesa perëndimore e Kranjës, në jug-perëndim të Liqenit të Shkodrës, rrethi i Tivarit). *Shënoi Simë Dobreci* më 10.10.2010. *Shih edhe versionet*: BUZUKU 2/2001:12, BUZUKU 25/2007:22, BUZUKU 26/2008:21, BUZUKU 24/2007:21

Në drrasë të vekut kush po kjanë

Në drrasë të vekut kush po kjanë?
 -Kjanë syzeza për jaran-ë,
 Gjeth e bar në mal i thanë,
 Nuk po e len verën me dalë,
 Nuk po e len me dalë sivjet,
 Për q'atë djalë ç'i ka dekë,
 Për q'atë djalë, q'atë djalë të ri.
 -A di nânë n'dhe ku e kanë shti?
 -N'Vorre t'G'jata nar ni bli.
 -A t'shkoj nânë me të të rri,
 Se kam pasë shum jarani.
 Âsht çua çika, âsht fillua,
 N'Vorre t'G'jata paska shkua.
 -Çou jaran me folë me mua,
 A e di besën ç'i m'ke dhânë,
 Kur me thoshe ç'i je azgan,
 Pushkë e top s'kanë çka të bâjnë!
 -Ama dorën çikë t'çohem n'kâmë,
 Ama dorën n'kam me u çua,
 Edhe i herë me bisedua.
 Opet n'vorr ti ke me m'lshua,
 E m'lsho n'vorr ti çikë opet,
 Ishalla përpiqem me ty n'xhenet!

Këndo një grup vajzash të fshatit Hot në bjeshkën Horollec në qershor 1975.

Shënoi Shaban Hasangjekaj,
 Martinaj, Guci



Karrige e mrekullueshme por e zënë (Muzeu në kalanë Rozafa, Shkodër)

FJALË TË URTA - Krajë

Ma mirë me dajtë se me pasë
 Si asht vendi bahet kuvendi
 E di gamari ku e vret samari
 Detit i ka hije vala e burrit fjala
 Nuk bje rrefta n'hitha

I mblohdën Albijona, Blerina, Elmedini, Enisa, Fatjona dhe Jonida nxënësi të klasës V të shkollës në Arbnesht-Krajë (11.02.2011)

Kënon zogeja mëllinj

Kënon zogeja mëllinj,
Nën do lar-ë e nën dëllinj.
Qi kënon, qi ç'thotë e mjera?
Ajo thotë mirë për veti:
-Kush e ka nusen të mirë,
Atë e thrasën-o në dazëm!
Aj në dazëm mos të shkonje,
Se ka dazën në shtëpi,
Ditë e natë lule në sy!
*

Kënon zogeja mëllinj,
Nën do lar-ë e nën dëllinj.
Qi kënon, qi ç'thotë e mjera?
Ajo thotë mirë për veti:
-Kush e ka nusen të keqe,
Atë e thrasën-o në mord!
Aj në mord-e mos të shkonje,
Se ka mord-e në shtëpi,
Ditë e natë ferra në sy!
*

Kënon zogeja mëllinj,
Nën do lar-ë e nën dëllinj.
Qi kënon, qi ç'thotë e mjera?
Ajo thotë mirë për veti:
-Kush është djale-e'j pamartuo,
Shiko, djale-e, shiko fort,
Se të ze, moj, i ziu mord.

Këndoi Prenë Dabaj, Gurrzë, Shestan.

Marrë prej Gjokë Dabaj, SHESTANI (vëllimi I), Ulqin-Tiranë-Prishtinë, 2004:683.

Pite, pite me shum sheqer

(Vuthaj&Martinaj)

Pite, pite me shum sheqer*
Lumja nâna me shum djel!
Ka shum djel e shum reja,
S'i zên shpia, s'i zên dera.
Kur u bâ vjehrra me dekë,
Po kjan nusja me lotë përpjetë.
-Lumja unë, po do me dekë!
Të filloj pitën me nizatet petë,
Të ziej hallmën, e hamë t'zetë,
E shtroj shtratin me tre dyshekë!
T'lumet na, vjehrra ka dekë!
Allahile, shtjerne thellë

Se po tutna mos po del
Edhe vjen – teshat na'j shtjerr!

*Marë prej Idriz Xh. Ulaj, KËNGË DHE VAJTIME NGA KRAHINA E PLAVËS DHE E GUCISË, Instituti Albanologjik Prishtinë, 2009:154.

Lumi djalë, nuse miri

(Vuthaj)

Knon turreci, knon bylbyli,*
Lumi djali, nusemiri!
Kush në dazum mos me thirrë,
Dazum ka gjithmonë në shpi,
Gjithë ditën – lule në sy,
Gjithë natën – mollë në gji!
*

Knon bylbyli, knon turreci

(Vuthaj)

Knon bylbyli, knon turreci,*
Mjeri djali, nusekeqi!
Kush në dekë mos me thirrë,
Dekë e ka gjithmonë i mjeri,
Gjithë ditën – morde në sy,
Gjithë natën – therrë në gji!

*Marë prej Idriz Xh. Ulaj, KËNGË DHE VAJTIME NGA KRAHINA E PLAVËS DHE E GUCISË, Instituti Albanologjik Prishtinë, 2009: 130,156.

Pjetër Zog'ja rri n'karrigë

(Popullore)

Pjetër Zog'ja rri n'karrigë¹
Mërrhën kunrat me llastikë²
N'shpellë të lucës³ do me ikë
Do me ikë e do me shkuo
Aty festë me shuguruo⁴.
Aferim Lena Lek'Beqit⁵
Dymdhet* dora⁶ i shtiv përpeqit
Dymdhet dora, dymdhet vœ⁷,
për me lutë festën e re,
edhe prev ugiç sharanin
për me pritë-e Gjur'Kromanin
e me te Mirko Milanin⁸.
Mirko Mila u vonuo
E përpeqi u-ufulluo.

Shih edhe Kush u bo sebet BUZUKU 25/2007:22.

*Shestanasit në vend dh përdorin ll.

1.Pjetër Zog'ja, shestanas, kryetar në komunën e Krajës (rrethi i Tivar) një kohë mbas Luftës I Botërore, u bë kundërshtar i festave, adeteve të moçme të Shestanit. N'atë kohë, katundet e Shestanit Naltë u morën vesh që të festojnë të gjithë një festë, Shpjetrin, kurse Shestani Poshtë - 1 nëntorin, ditën e t'Gjidh Shenjtëve.

2. kunrat me llastikë - kundra luksoze të asaj kohe.

3.N'shpellë të lucës - në ferr.

4.Shuguruo – festua.

5.Lena Lek'Beqit ka qenë prej katundit Nrekaj Naltë, pej Gjurajsh; ishte çole (sakate), mendjehollë dhe e ndershme. Shumë kohë i bëri hysmet patër Stakës, priftit italljan, i cili banonte në Nrekaj.

6.dora, këtu, masa për djathë.

7.œ si në gjermanishte *ö/oe*; vœ, vœsë, vœsë (ve/vezë, vesë).

8.Mirko Milani - atëherë kryetar në Shestan.

Tregoi Angja (23.8.1915-), e ama e Gjonit Markut Gjonit Gjek'Lula, Kuçe, Totosh, Ulqin, me rranxë prej Briskut (pjesa perëndimore e Kranjës, në jug-perëndim të Liqenit të Shkodrës, rrethi i Tivarit). Shënoi Simë Gjon Dobreci më 10.10.2010.

O i mjeri, more nanë

O i mjeri, more nanë
Me mloj borçi n'tana anë
Me shitë babën, s'po bân pare
Me shitë nânën, po m'vjen marre
Pos ka ardhë i ziu gazep
Me shitë djali vashën e vet
Kur kënojë-e gjeli parë
Çou vashe me dalë n'pazâr
Kur kënojë-e gjeli dytë
Çou vashe me dalë m'u shitë
Sâ bân vasha, o bre djalë
Gjasht qin grosh, pazari parë
Për pesqin, ty t'kjothtë falë.

Tregoi Angja (23.8.1915-), e ama e Gjonit Markut Gjonit Gjek'Lula, Kuçe, Totosh, Ulqin, me rranxë prej Briskut (pjesa perëndimore e Kranjës, në jug-perëndim të Liqenit të Shkodrës, rrethi i Tivarit). Shënoi Simë Gjon Dobreci më 10.10.2010.



Kalimerat në Bunë

Qesh e njesh

1.Ironia e fatit asht se gjithë jetën ta krypin mendjen e ti vdes prej sheqerit!

2.Kola: "Gruja ime asht engjell!" Gjoni ia ktheu: "I lumi ti! E imja asht ende gjallë!"

3.Heshtja parazgjedhore asht e vetmja ditë kur politikanët nuk gënjejnë!

4.Cigarja asht mjet pështjellak e cila në njanën anë ka zjarmin kurse n'anët tjetër /ka/ idiotin!

5.Mashkujt janë si shkrepstat. Kur ndezen i humbin kokat!

6.Grosha e mirë ndigjohet larg!

7.Natën e parë të martesës burri e pyet nusen: - A u mërzite që e le nanën?! - Ajo: - Qe besa aspak, por u mërzita shumë që e gjeta nanën tan'e!

Pëgatiti Nikë Palkola, Kllezën, Ulqin, tash në Nju Jork, Amerikë

O, kush ta bâni, more, kush ta bâni?
O, vetja, more, vetja ma bâni.

Ekipi Sportiv BIJTË E SHESTANIT

Në vazhden e shumë aktiviteteve që kanë ndodhur në Ulqin dhe rrethinë, si, për shembull, festimi i festës së shën Valentinit, festa e të moshuarve, udha e Kryqit në Salç, festa e mërgimtarëve, festa e ushqimeve tradicionale për Pashkët. Edhe sporti ka zënë një pjesë të aktiviteteve të famullisë Braticë - Kullomzë. Është formuar ekipi i futbollit "Bijtë e Shestanit", ekip që ka marrë pjesë në aktivitete sportive në shumë vende brenda dhe jashtë shtetit si në Tivar, Podgoricë, Shqipëri (Shkodër, Lezhë), Kosovë (Klinë), Zvicër (Arau). Në këtë aktivitet sportiv nuk ishte qëllim vetëm sporti, por me tepër si një mundësi e njohjeve të reja dhe përvojave të reja, që të rinjtë kanë përjetuar në këto aktivitete sportive.

Ja vlen ta përmendim pjesëmarrjen tonë në aktivitetin sportiv të organizuar nga Misioni Katolik Shqiptar në Arau, Zvicër. Pak ka rëndësi suksesi sportiv, por rëndësi të madhe kishte njohja me diasporën katolike shqiptare në Zvicër, njohje dhe miqësi të reja me familjet që jetojnë në Zvicër, me mikpritjen shqiptare që kemi përjetuar në secilin vend dhe në secilën familje.

Kemi përjetuar çaste shumë të mira duke parë dhe arritjet që atje diaspora

jonë kishte arritur. Patëm raste që arritjet e diasporës shqiptare t'i takojmë në çdo qytet.

Një kontribut të veçantë për arritjet dhe sukseset në atë vend e kishte dhënë edhe Misioni Katolik Shqiptar që natë e ditë ju qëndronte pranë besimtarëve të vetë.

Edhe ne jemi ndier krenar për sukseset e tyre, ishim krenar kur takuam bijtë e Shestanit, që jetonin dhe punonin atje dhe për suksesin që ata kishin arritur aty. Pra, secila ditë ishte e mbushur me përvoja të ndryshme. Sporti është një mjet i mire për të kontribuar në edukimin, kulturimin e rinisë tone. Ky angazhim çdo ditë e më shumë është duke u rritur.

G.G. Buzuku Press



Mallkime të Plavë-Gucisë

Ardhsh me krye përpara.
Të gjoftë moti për së kthjellti.
Mos i hângësh dy bukë n'i vend.
M'i marrësh të ligat e shtatit.
Ta niefsha kumtin e zi në shpi.
Ta pasha bajrakun e zi në çati.
Të laçin mentë e kresë.
Mos e niefsh qyqen n'mal.
Të metë kafshata në fyt.
Të kopt mullza e barkut.
Mos të ruajt Zoti.
Ta theftë dreqi qafën.
T'u shapofshin kâmtë.
T'i piftë dreqi ment e kresë.
T'u qorrofshin sytë e ballit.
T'u laftë shtati me gjak.
T'u marrtë goja n'hyqymet.
Të plastë zemra e barkut.
Daç e mos mujsh.
E mramja t'ardhtë me sherr.
Shkofsh e mos u kthefsh.
Mos u rahatofsh.
Mos pafsh ditë të bardhë.
T'u zâftë fryma.
Metsh me gojë hapun.
U çofsh lugat.
Dreqi ta ditë për nerë.
Mos të shkoftë puna marë.
Ta marroftë Zoti ftyrën.
Mos t'u rritë fisi.
T'u fikt hisja.
Mos pastë kush n'dhe me t'shti.
T'u thaft goja.
Të metë kafshata n'fyt.
Metsh me gishta n'gojë.
Shih edhe Buzuku 33/2010:23
Shënoi Shaban Hasangjekaj,
Martinaj, Guci, 5.12.2010

Ndihmuan revistën *Buzuku* 35

(Renditja si mbas abecedës)

Albana Selim Mehmeti, Draginjë, Ana e Mait, Ulqin-€20

Anti Luks Gjoks Pers Kols-Xhikaj, Braticë, Ulqin-€10.

Gjergji Kol's Luk's Macit Luk'Pâlit-Pecaj, Mali Bardhë, Ulqin, tash n'Ft.Lauderdale, Florida, Amerikë-\$100.

Loro Pal'Kol'Paloka-Markaj, avokat, Ulqin-€50.

Lukë Dedë Shkreli, Amull, Ulqin, tash në Ubstadt-Weiher, Germani -\$50.

Marian Palokë Shkreli, Gjerana, Ulqin-€20.

Mefit Jakup Mani-Jakupi&Hajro Shaban Bego-Shabani, AGRO-FARMA, Ulqin-€50.

Nikë Palkola, Kllezën, Ulqin, tash Nju Jork, ShBA-€40.

Stjepa'j Nik's Stjep's Zefit Pjetërgjon-Nilaj, Braticë, Ulqin, tash n'Zvicër-€100.

Vinçenc Vulaj, Tuz-€10.

Ju po e mundësoni botimin e revistës. Redaksia u falet nderit. Qofshi gjithmonë faqe bardhë.

*

Ndihmuan Forumin Rinor dhe Folklorin

Gjergji Rrokut Jakut Zefit, Bishti Malit, Ulqin-€50.

Gjoka'j Niks Preçit-Marniku, Bashnjë, Ulqin-€50.

Jak Koçoviqi, Kllezën, Ulqin-\$30.

Jaku'j Sims Jakut-Pepgjononj (Pepgjonoviq), Gragja Komerc, Ulqin-€100.

Jakup Murati, pronar i hotelit LONDON, Ulqin-€50.

Marku'j Antit Markut Gjonit, Stanaj, Bishti Malit, Ulqin-\$100.

Nikollë Mati Dukagjini, Ulqin-€50.

Pjetri Antonit Pjetrit Macit, Marnikaj, Bashnjë, Ulqin-€50.

Prenci Sims Jakut, Bostane, Ulqin, tash n'Boston, Amerikë-\$200.

Sandri Pals Jakushit, Marnikaj, Bashnjë, Ulqin-€30.

Shogata Don Gjon Buzuku u falet nderit. Qofshi gjithmonë faqe bardhë.



REKLAME L & G Design

Mob: 067 556 977 ; 067 581 900 www.lgdesign-ul.com

GRADJACOMERC

- VODOVODNI MATERIJAL
- ELEKTRO MATERIJAL
- METALNA GALANTERIJA
- ALATI
- TEHNIČKA ROBA
- BOJE I LAKOVI

Pravi ključ za Vašu kuću!!!
UVOZ I DISTRIBUCIJA

Tel/fax: +382 30 411-600;
Mob: +382 69 023 979
e-mail: gradjacomerc@t-com.me
www.gradjacomerc.com

Për shumot Pashkët



Kujdes - luani ruan Kalanë

Kalaja e Ulqinit ia kalon florinit

